



• ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER
SHKURT 2006, Nr 21

Dr. Ibrahim Rugova:

Një njeri me aftësi të bashkojë



Zhvillimet e fundit në Kuvend

Editoriali



Gjatë vitit 2005, Kuvendi i Kosovës ka filluar të veprojë në një kontekst të ri politik.. Qeveria e koalicionit u formua dhe zhvilloi një varësi të grupeve parlamentare të LDK-së, AAK-së dhe 6+ në Kuvendin e Kosovës. Grupet parlamentare të PDK-së dhe ORA-s u bënë shumë të zëshme në kundërshtimin e tyre ndaj politikave qeveritare. Në përgjithësi, Kuvendi ia doli të vazhdojë punën me miratimin e ligjeve të reja, si dhe ka zhvilluar një sërë debatesh mbi çështjet vitale politike.

Në anën tjetër, u bë më se e qartë se Kuvendi i Kosovës po përballëj me probleme të shumta si pasojë e takimeve të shpeshta, përcaktimit të agjendës, interpelancave me ministrat dhe debatet e përgjithshme mbi politikat. Gjatë seancave plenare në nëntorë dhe dhjetorë 2005 si dhe janar 2006, anëtarët e Kuvendit kërkuan më shumë seanca të rregullta për të diskutuar një spektër të gjerë të çështjeve dhe sfidave politike dhe shoqërore. Në raportin e tij të fundit mbi Kosovën, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Kofi Annan ka deklaruar "Nevojitet progres urgjent për ti mundësuar Kuvendit të Kosovës që të jetë forum qëndror për debat demokratik." Së këndejmi, gjatë seancës plenare, Kryetari i Kosovës deklaroi se është në përgatitje e sipër një 'Plan i Veprimit' për Kuvendin e Kosovës, i cili do të bëhet i njohur së shpejti. Kjo iniciativë duhet përshendetur, ngase me miratimin e këtij plani veprues pritet që Kuvendi të përmirësojë thelbësisht funksionimin dhe njëherit ta rrisë aktivitetet e tij.

Në të njëjtën kohë, Kuvendi mund të llogarisë në më shumë asistencë të specializuar nga ana e tri institucioneve kryesore që punojnë me Kuvendin: Institutin Nacional Demokratik (NDI), Projektin e Agjencionit European për Rindërtim (AER) dhe Misionin e OSBE-së në Kosovë. NDI tani ka drejtorin e ri për Kosovë dhe kryesuesin e ri për programin legjislativ, që të dy jashtëzakonisht të përkushtuar në ofrimin e përkrahjes së tyre si për Kuvendin ashtu edhe për komisionet parlamentare. Projekti i ri i AER-it 'Përkrahja e vazhdueshme Kuvendit të Kosovës' është duke u inicuar nga ana e Konzortiumit të Parlamenteve të Francës, Belgjikës, Gjermanisë, Sllovenisë dhe Institutit Ndërkombtarë të Parisit për Mbrojtje. Misioni i OSBE-së në Kosovë është duke e prioritetizuar asistencën e vet në mbikëqyrjen parlamentare në lëminë e sigurisë, buxhetit dhe implementimit të ligjeve, duke e plotësuar në vijim edhe me angazhimin e një këshilltari të huaj për Kryetarin e Kuvendit. Me fillimit e vitit 2006 po bëhet gjithnjë më e qartë që asistencë ndërkombëtare për Kuvendin e Kosovës po bëhet gjithnjë e më konsoliduar përmes programeve të shtuara të NDI/USAID-it, AER-it dhe OSBE-së.

Edicioni i fundit i buletinit ASI fokusohet në programet e të tri këtyre organizatave, si dhe në punën e vazhdueshme parlamentare gjatë dy muajve të fundit. Shpresojmë të jetë me interes për ju dhe mirëpresim komentet tuaja.

*Franklin De Vrieze,
Kordinatori i Iniciativës për Mbështetje Kuvendit -ASI*

Editoriali	2
Një njeri me aftësi të bashkojë	3
Kryesuesi i Zyrës së OSBE-së shprehë ngushëllimet e tij për vdekjen Presidentit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova	6
Deklarata e Grupit të Kontaktit për të ardhmen e Kosovës	7
Zëri autentik i përfaqësueseve	8
Prespektivë evropiane për Kosovën	9
E drejta e komunitetit turk për përdorimin e gjuhës	10
Zhvillimet e fundit në Kuvend	11
Zbatueshmëria e ligjeve	12
Prezantimi i raportit mbi implementimin e ligjeve në Kuvend	13
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm – shtylla qëndrore për përgjegjësinë publike	14
Përfundimi i Projektit SPEAK	15
Kuvendi miratoi Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2006	16
Projekti i ri i AER-it	17
Iniciativat e NDI-së për vitin 2006	18
OSBE-ja ofron këshilla për Kuvendin e Kosovës	19
Vizioni dhe plani i veprimit për të ardhmen	20
Performanca e Kuvendit nga një këndshikim tjetër	21
Kontrolli parlamentar i sektorit të sigurisë	22



Seanca komemorative e Kuvendit të Kosovës me rastin e vdekjes së Presidentit Rugova me 22 janar.

Një njeri me aftësi të bashkojë


Arben Qirezi në Prishtinë (Balkan Investigative Reporting Network, Balkan Insight, 25 janar 2006)

Vdekja e Presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, me 21 janar, është test i madh për kosovarët derisa ata hynë në fazën përfundimtare të definimit të statusit politik të vendit. Njeriu i cili është konsideruar babai themelues i nacionalizmit modern kosovar, dhe një lider i jashtëzakonshëm, ka ndërruar jetë para se të jetësohet ëndrra e tij për Kosovë të pavarur.. Tani i mbetet liderëve të tjerë kosovar të realizojnë trashëgiminë e tij.

I lindur në vitin 1944 në Cërce, në perëndim të Kosovës, ky intelektual i arsimuar në Sorbonë i takonte elitës kulturore të Prishtinës e cila u krijua gjatë fundit të gjashtëdhjetave dhe ishte aktive gjatë të shtatëdhjetave dhe tetëdhjetave.

Gjatë të tetëdhjetave, kjo elitë intelektuale, epërbërë kryesisht nga gazetarë, akademikë dhe shkrimtarë, filloi të rimendojë shoqërinë kosovare pas shumë viteve të sundimit të Presidentit Tito. Rebelimi i vitit 1981, me kërkesat që Kosova të gëzojë status të republikës brenda federatës jugosllave, nxiti kërkesa nga Beogradi për pezullimin e statusit autonom të Kosovës brenda Jugosllavisë.

Në ballë të kësaj lëvizje ishte Asociacioni i Shkrimtarëve të Serbisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve në Serbi, të cilat filluan një platformë politike për nacionalizëm serb bazuar në pohimet për vuajtje të serbëve në Kosovë dhe nevojës për të "ribashkuar Serbinë."



Dr. Ibrahim Rugova

Si president i Asociacionit të Shkrimtarëve të Kosovës, Rugova kundërshtoi këtë platformë. Duke u paraqitur fillimisht si intelektual, në mbrojtje të drejtave të popullit të tij, e jo si politikan, ai hapur kundërshtoi politikën serbe në Kosovë.

Edhe pse nga perspektiva e sotshme kjo mund të mos konsiderohet shumë e rëndë-

sishme, ky kundërshtim i politikës serbe shndërroi Rugovën në udhëheqës në sytë e kosovarëve. Në të njëjtën kohë, proceset gjyqësore me dënime deri 15 vjet burg ishin të zakonshme në Kosovë për të ashtuquajturat delikte verbale. Pak njerëz kishin guxim të kundërshtojnë politikën zyrtare të Beogradit.

Me shuarjen e autonomisë së

Kosovës me 23 mars, 1989, rezistenca ndaj qeverisjes serbe në Kosovë u bë më e hapur. Pas shpartallimit të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, një grup intelektualësh të udhëhequr nga Rugova me 23 dhjetor, 1989 themeluan Lidhjen Demokratike të Kosovës, LDK. Themelimi i saj ishte goditja përfundimtare e udhëheqësisë marionette

komuniste të Kosovës të udhëhequr nga ish shefi i policisë dhe aleati i Sllobodan Millosheviqit, Rahman Morina.

Në atë kohë Rugova vetëm ishte bërë i njohur për mbrojtjen e tij publike për të drejtat e shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë, pozita politike e tij si lider i Kosovës ende nuk ishte konsoliduar. Apeli i Rugovës ndaj të rinjve për të ndaluar protestat në janar dhe shkurt 1990, ku rreth 30 protestues të paarmatosur pësuan vdekje, ra në vesh të shurdhër.

Forca brutale e autoriteteve serbe bindën Rugovën se strategjia më e mirë për të luftuar shtypjen serbe ishte lëvizja paqësore, e cila do të fitonte mbështetje ndërkombëtare.

Deri me 4 korrik 1990, as LDK-ja dhe as Beogradi nuk kishin konsoliduar plotësisht pozicionet politike të paramenduara. Derisa Prishtina po kërkonte kthimin e statusit të saj nën kushtetutën jugosllave të vitit 1974, të anuluar një vit më parë, këto kërkesa po lëviznin në drejtim të kërkesës për republikë të pavarur brenda federatës jugosllave. Beogradi gjithashtu ende nuk kishte hequr strukturat e mbetura vetëqeverisëse të Kosovës.

Në përgjigje të shpartallimit të ish Jugosllavisë, me 2 korrik, 1990, parlamenti i Kosovës shpalli Deklaratën për Pavarësi, të përpiluar nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Rugovës, përfshirë presidentin e ndjerë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Gazmend Zajmi, dhe nënkryetarin e LDK-së, i ndjeri Fehmi Agani.

Ky ishte momenti kthyes në

karrierën e Rugovës si lider i pamohueshëm i Kosovës. Ylli I tij politik u ngrit përmes konceptit të pavarësisë së Kosovës dhe konsiderohej si njeriu i vetëm i cili mund të homogjenizonte shqiptarët e Kosovës për këtë ide të re.

Roli i Rugovës në formësimin e shoqërisë kosovare ishte vendimtar në zhvillimet e mëtutjeshme në rajon. Për dhjetë vite ai bashkoi popullatën kosovare rreth idesë së pavarësisë, emancipimit politik të kosovare duke e orientuar drejtë vlerave perëndimore dhe internacionalizoi çështjen e Kosovës.

Konceptet e tij politike dhe sociale ishin inspiruar nga baballarët themelues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe lufta e Amerikës për pavarësi, së bashku me kombinimin e vlerave të liberalizmit social dhe tradicional të Shteteve të Bashkuara. Ai gjithashtu ishte i ndikuar nga vlerat e Revolucionit francez.

Në atë kohë ai shpesh pohonte se edhe pse fillimi i një konflikti të armatosur do të ishte i lehtë, kjo do të kishte pasoja kundër produktive jashtë vendit. “Kosovës i nevojiten miq që do ta mbështesin synimin e saj,” thoshte Rugova.

Në të vërtetë, fitimi i mbështetjes ndërkombëtare për synimin e Kosovës ishte shtylla kryesore e strategjisë së tij. Ai arriti të fitojë njohjen ndërkombëtare dhe u prit nga shumë kryesues të shteteve dhe qeveri dhe ministra të jashtëm në ShBA dhe Evropë. Ai i kushtoi rëndësi të madhe marrëdhënieve me ShBA-të, vendet e Bashkimit Evropian dhe Vatikanin, dhe kishte marrëdhënie të ngrohta me Papën Gjijn Palin II.

Edhe pse kritikant ndaj udhëheqësisë së tij kurrë nuk pushuan asnjëherë, hendi kepi i kundërshtarëve të tij ishte fakti se orientimet kryesore strategjike të Rugovës gëzonin mbështetje të plotë të kosovarëve. Një aftësi për të parashikuar proceset e mbështollit atë me një aureolë të vizionarit. Në një intervistë me Televizionin e Shqipërisë në vitin 1996, për shembull, ai parashikoi një plan në të ardhmen që do të përfshinte një prezencë ushtarake dhe civile ndërkombëtare, krijimin e institucioneve demokratike në një periudhë transitore dhe njohjen formale të pavarësisë së Kosovës me garanci ndërkombëtare për minoritetin serb. Për shumë persona të përfshirë në zhvillimet e tanishme të Kosovës, kjo duket si një “dëjã vu”.

Vizioni i Rugovës kishte vlerë përtej Kosovës. Pas deklaratës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës me 9 shtator, 1990, në Kaçanik, e cila u deklarua fshehtëzi nga parlamenti i shpërndarë i Kosovës, u krijuan një Këshill Konsultativ i Partive Politike Shqiptare në ish-Jugosllavi, me qëllim të koordinimit të lëvizjeve politike gjatë shpartallimit të ish Jugosllavisë. Rugova ishte udhëheqës i këtij këshilli.

Platforma e këtij këshilli do të shndërrohej në orientim kryesor për zgjidhjen e çështjes shqiptare në ish Jugosllavi gjatë dhjetë viteve të ardhshme. Pikat kryesore ishin pavarësia

e Kosovës, statusi i popullit konstitutiv për shqiptarët në Maqedoni, autonomi për shqiptarët në Luginën e Preshevës në jug të Serbisë dhe status special për shqiptarët në Mal të Zi. Përmes këtij këshilli, Rugova morri udhëheqësinë politike mbi të gjithë shqiptarët në ish Jugosllavi. Megjithatë strategjia e tij varej nga fakti nëse Jugosllavia do të mbijetonte si shtet apo do të shpartallohej në muajt vijues.

Shpartallimi i vendit në vitet 1991 dhe 1992 detyroi shqiptarët të ndërrojnë strategjinë e tyre. Në vend të veprimit si një entitet i vetëm brenda një shteti, çdo entitet shqiptar brenda ish Jugosllavisë tani do të ndiqte agjendën e vet. Për të krijuar bazën politike për pavarësi, LDK-ja në shtator 1991, organizoi referendumin për pavarësi të Kosovës në të cilin më shumë se 80 përqind të votuesve të Kosovës morën pjesë, dhe rreth 99.9 përqind votuan në mbështetje të pavarësisë. Serbët e Kosovës bojkotuan referendumin, i cili u organizua fshehurazi, derisa aktivistët politik shkonin në çdo shtëpi për të shpërndarë fletëvotimet.

Po atë vit, Këshilli Konsultativ i Partive Politike të Kosovës pranoi propozimin e Rugovës për të krijuar qeverinë e Kosovës në ekzil nën udhëheqjen e Bujar Bukoshit si kryeministër. Qeveria krijoi një taksë jozyrtare prej tre përqind për shqiptarët në diasporë dhe në Kosovë për të mbështetur

“Udhërrëfyesit e Kosovës Demokratike – vendit që i takon gjithë qytetarëve, të cilët jetojnë dhe zhvillohen në liri dhe barazi pavarësisht përkatësisë etnike, na udhëzofshi drejt finalizimit të projektit të Presidentit Rugova, i cili qysh sot do të pushojë në Dardaninë antike - Kosovë” deklaroi Kryetari i Kuvendit të Kosovës - Nexhat Daci.

“Kosova, në këto momente derisa po nderon Presidentin e Pavarësisë, ka hyrë në fazën qenësore të demokratizimit, lirisë dhe pavarësisë. Kosova po tregon që mund të jetë faktor i rëndësishëm për sigurinë dhe stabilitetin në rajon” deklaroi kryeministri Bajram Kosumi.

sistemin arsimor, shëndetësor dhe humanitar sidhe aktivitetet politike të LDK-së. Edhe pse qeveria vepronte në ekzil, sektorët e saj financiar, arsimor dhe shëndetësor funksiononin si institucione paralele në Kosovë. Brenda vendit, arsimit ishte shtylla kryesore e këtij sistemi paralel dhe që nga viti 1991 shkollat në gjuhën shqipe vijoheshin me rregull dhe në mënyrë masovike.

Pasi Rugova i dha rëndësi të madhe marrëdhënieve të jashtme, zyrat përfaqësuese të Kosovës u hapën në kryeqytetet evropiane.

Bukoshi nuk ishte i kënaqur me rolin e tij në vendimmarrje, dhe në një ballafaqim ai hapur sfidoi autoritetin e Rugovës. Megjithatë, Rugova nuk e ndërroi atë nga posti i tij, edhe pse kjo mund të bëhej lehtë.

Me 24 maj, 1992, u organizuan zgjedhjet e paraparlamentit dhe presidentin e Kosovës. Rugova, pa kundërshtarë për postin udhëheqës, fitoi gati 100 përqind të votave derisa LDK fitoi më shumë se 90 përqind të vendeve në parlament, i cili megjithatë në realitet asnjëherë nuk u mblodh, pasi forcat serbe parandaluan këtë.

Këto zgjedhje përfaqësuan një epokë të re në lëvizjen e shqiptarëve të Kosovës për pavarësi, pasi këshillet e vjetra konsultative u ndërruan me të ashtuquajturat institucionet paralele, të cilat vepronin në emër të Republikës së Kosovës. Rugova fitoi legjitimitet popullor dhe filloi të veprojë si president i zgjedhur. Derisa mbështetja kryesore për këtë sistem ishte LDK-ja, partitë e tjera gjithashtu ishin të përfshira. Në këtë mënyrë, skena politike e shqiptarëve të Kosovës filloi të marrë formën, me mbështetës dhe kundërshtarë të Rugovës.

Për të mënjeluar përçarjet në anën kosovare, Rugova përfshiu ish të burgosur politik të njohur në udhëheqësinë e LDK-së në kuvendin e partisë në vitin 1994. Ky fraksion bashkëjetoi

me LDK-në deri në vitin 1998, kur u nda për të themeluar një parti të re nën udhëheqjen e Rexhep Qosjes, kritik kryesor i politikave të Rugovës gjatë të nëntëdhjetave.

Shpresat se Kosova do të fitonte pavarësinë përmes rrugës paqësore u zbehën në vitin 1995 me arritjen e marrëveshjes paqësore të Dejtonit, e cila nuk përfshiu Kosovën në kontekstin e krizës në ish Jugosllavi. Edhe pse Rugova vazhdoi të gëzojë mbështetjen e shumicës së kosovarëve, kundërshtarët e rinj të rezistencës së tij paqësore filluan të organizojnë një forcë rebeluese, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, UÇK, kryesisht në luginën e Drenicës, e Kosovë qendrore dhe në rrafshin e Dukagjinit në përfundim të Kosovës.

Duke vepruar në fshehtësi të plotë, UÇK ishte e njohur vetëm për pjesëmarrësit e saj. Shumica e kosovarëve nuk besuan në ekzistencën e saj deri me 28 nëntor, 1997, kur, gjatë varrimit të një mësuesi të vrarë nga policia serbe në fshatin e Llaushës, në qendër të Kosovës, tre liderë të UÇK-së shpalosën platformën e UÇK-së për një kryengritje të armatosur.

Fehmi Agani, dora e djathtë e Rugovës, pranoi realitetin e ri, duke deklaruar ditën e nesërme se, “UÇK-ja është një forcë pa të cilën çështja e Kosovës nuk mund të adresohet dhe zgjidhet.” Kjo deklaratë doli e vërtetë gjatë dy viteve të ardhshme, kur UÇK-ja u shndërrua në një forcë guerile dhe morri nën kontroll zhvillimet në Kosovë.



Kryesuesi për politikë të jashtme i BE-së, Javier Solana deklaroi: “Është ironi e vrazhdë e historisë, që na braktisi në momentin kur na duhej më së shumti, në momentin kur pritej nga ai të ofrojë lidhshmëri dhe statusit të ardhshëm të Kosovës.”

Nënkryetari i LDK-së President Kolë Berisha gjatë ceremonisë mortore tha që Kosova ka humbur artikulatortin e lirisë dhe pavarësisë. 'Kosova ka humbur burrin dhe liderin e guximshëm historik i cili bartë në vete jo vetëm formacionin, zhvillimin dhe konkurat e partisë së parë më të madhe politike LDK-së, por edhe 16 vite të historisë së përbashkët me shqiptarët në Kosovë dhe më gjerë.

Një tentim nga Richard Holbrooke, yll i Dejtonit, për të filluar procesin negociues në mes të Prishtinës dhe Beogradit në maj 1998 dështoi. Millosheviqi kishte vendosur që t'i qëronte hesapet me shqiptarët një herë e përgjithmonë. Në vend të kësaj, Rugova u pranua në Shtëpinë e Bardhë nga Presidenti i ShBA-ve, Bill Clinton, me 29 maj, 1998.

Rugova publikisht mbeti në anën e rezistencës paqësore ndaj sundimit serb gjatë luftës së viteve 1998 dhe 1999. Në zgjedhjet e organizuara në mars 1998, ai u rizgjodh president i Kosovës. Gjatë

I dërguari special i SHBA-ve presidentit Xhorxh Bush, sekretari Alfonso Xhekson, tha që SHBA-të janë të përkushtuara ndaj vizionit të Presidentit Rugova. "I inkurajojë udhëheqësitë dhe popullin e Kosovës që të jenë të bashkuar dhe të punojnë në rrugën e trasuar të Presidentit Kosova. Tani është koha që të bashkohen dhe të çojnë deri në fund punën e Rugovës dhe të negociojnë për të ardhmën e vendit." shtoi Jackson.

sulmeve ajrore të NATO-s kundër Serbisë, ai ndau fatin e shumicës kosovare dhe qëndroi në shtëpinë e tij në Prishtinë, edhe pse shumë mbështetës të tij iu bashkëngjitën UÇK-së, derisa vazhduan të besojnë në udhëheqësin e tij.

Nën arrest shtëpiak, dhe me kërcënime të vazhdueshme ndaj familjes së tij, si shpjegoi ai gjatë dëshmisë kundër Millosheviqit në Hagë në vitin 2002, Rugova u detyrua të paraqitet para kamerave televizive pranë armikut të tij më të madh. Shumë njerëz besuan se kjo ishte shenjë e dobësisë së tij dhe menduan se kjo do të përfundonte karrierën e tij politike. Megjithatë, shumica e kosovarëve konsideruan qëndrimin e Rugovës për të mbetur në Kosovë gjatë bombardimeve si shenjë e kundërshtimit të tij paqësor ndaj sundimit serb dhe paraqitja televizive u konsiderua si një incident të cilin ai nuk e kishte dëshiruar. Ky perceptim u konfirmua në zgjedhjet e para të lira në Kosovë kur LDK-ja fitoi më shumë vota se çdo parti tjetër.

Megjithatë, prej atëherë deri në zgjedhjet e para lokale në vitin 2000, ku LDK-ja fitoi 64 përqind të votave, pozita politike e Rugovës në Kosovës ishte e brishtë. Udhëheqësia politike dhe shoqërore në Kosovë kishte kaluar në anën e liderëve të UÇK-së.

Duke konfirmuar popullaritetin e tij të pamohueshëm si lider, LDK-ja e Rugovës vazhdimisht u votua si partia më e popullarizuar në Kosovë në katër zgjedhje të ardhshme, në vitet 2000, 2001, 2002 dhe 2004. Përkundër përçarjeve të brendshme nga e cila dolën dy

parti të reja, Rugova mbeti pa dyshim si lider i pamohueshëm i Kosovës. Grupet politike që dolën nga LDK-ja kurrë nuk arritën të fitojnë mbështetje të mjaftueshme për të fituar mandate në parlamentin e Kosovës.

Njoftimi për sëmundjen e tij në shtator 2005 tregoi sa i rëndësishëm ende ishte Rugova në sytë e mbështetësve si dhe rivalëve. Ideja se Kosova do të hynte në bisedat për status përfundimtar pa te ishte e padëshiruar nga të gjitha anët.

Rugova ishte, në fakt, personaliteti i vetëm në Kosovë me fuqinë të bashkojë të gjitha fraksionet kur ishte e nevojshme. Ai nuk ishte vetëm lider por gjithashtu një simbol i asaj që të gjithë dëshironin Kosova të jetë. Vdekja e tij

është një test i madh për partitë politike të Kosovës të cilat nuk kanë zgjidhje përpos të mbështeten në të trashëgiminë e tij për të përmbushur ëndrrën për të cilën ai kishte luftuar.

Në ndërkohë, partia e tij, LDK-ja, duhet ta rikrijojë vetveten në muajt e ardhshëm. Partia e cila e kryesoi luftën për pavarësi nën udhëheqjen e Rugovës duhet të gjejë një agjendë të re e cila do t'i përshtatet periudhës së re në të cilën po hyn Kosova.

Arben Qirezi ishte zëdhënës i ish kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Ai gjithashtu ka punuar si bashkëpunëtor dhe redaktor i IWPR në Kosovë. Ai tani është këshilltar i presidentit të Aleancës për Ardhmëri të Kosovës, AAK.

Kryesuesi i Zyrës së OSBE-së shprehë ngushëllimet e tij për vdekjen presidentit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova

Kryesuesi i Zyrës i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) Ministri i Punëve të Jashtme të Belgjikës Karel De Gucht, posa ka marrë lajmin për vdekjen, ka shprehur ngushëllimet e tij popullit të Kosovës dhe familjes së Presidentit Ibrahim Rugova.

"Më ka kapluar ndjenja e humbjes së madhe për vdekjen e parakohshme të personit i cili qëndroi për të gjetur një të ardhme paqësore dhe demokratike për Kosovën e tij të dashur," u shpreh ai.

Kryesuesi i Zyrës shtoi duke thënë që falënderimi më i madh që mund t'i bëhet në këto momente është të vazhdohet në rrugën e njëjtë paqësore: "Ne duhet të tregojmë respektin ndaj tij duke mos lejuar që vdekja e tij në këtë kohë kaq të ndjeshme të ndryshojë prospektin për një zgjedhje afatgjate. OSBE do të vazhdojë t'a mbështesë fuqishëm atë."

Lajmi për vdekjen e tij u prit me keqardhje edhe nga Kryesuesi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadori Uerner Vnent: "Presidenti Rugova do të na mungojë shumë. Prezenca e tij ka reflektuar stabilitet në Kosovë për shumë vite dhe shembulli i tij duhet të vazhdojë të na frymëzojë."

Deklarata e Grupit të Kontaktit për të ardhmen e Kosovës



Londër, 31 janar 2006

Ministrat e Grupit të Kontaktit së bashku me Përfaqësuesin e Lartë të BE-së, Kryesinë e BE-së, Komisionerin European për Zgjerim, Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s dhe përfaqësuesit e KB-ve përfshirë edhe të Dërguarin Special për Status të KB-ve, u takuan më 31 janar në Londër. Me këtë rast, ministrat shprehën keqardhjen e tyre të thellë për humbjen e Presidentit Ibrahim Rugova, i cili kishte fituar respektin e mbarë botës për përkrahjen e tij parimore për të drejtat e njeriut dhe demokracinë.

Njëherit, ministrat thkesuan edhe rëndësinë që i kushtojnë ata gjetjes së një zgjidhjeje afatgjate dhe të qëndrueshme për statusin e Kosovës, e cila promovon krijimin e shoqërisë multi-etnike. Kjo do ta shtonte pa masë stabilitetin në rajon, si edhe perspektivën europiane dhe euro-atlantike jo vetëm

për Serbinë dhe Kosovën por edhe për rajonin në tërësi. Po kështu, ministrat përkujtojnë natyrën e problemit të Kosovës, e krijuar me shpërbërjen e Jugosllavisë, që u pasua nga konfliktet, pastrimi etnik dhe ngjarjet e vitit 1999, si dhe periudha në vazhdim e administrimit ndërkombëtar nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (RKSKB 1244), duhet të mirret plotësisht parasysh me rastin e zgjidhjes së statusit të Kosovës. RKSKB 1244 vazhdon të mbetet korniza bazë për procesin e përcaktimit të statusit, ku Këshilli i Sigurimit dhe Grupi i Kontaktit do të vazhdojnë të luajnë rolet kryesore.

Ministrat besojnë, që duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme, që të arrihet një zgjidhje me marrëveshje gjatë vitit 2006. Së këndejmi,

ministrat mbështesin fuqimisht punën e të Dërguarit Special të KB-ve Martti Ahtisaari. Ata i bënë thirrje Beogradit dhe Prishtinës të punojnë në mënyrë konstruktive me të, dhe të gjejnë zgjidhje racionale për shumë çështje të vështira, që duhet të adresohen. Ndër të tjera këtu duhet të përfshihen edhe liria e lëvizjes, lidhjet transparente dhe konstruktive ndërmjet komuniteteve lokale në Serbi dhe Kosovë, mekanizmat për zgjidhjen e fatit të të pagjeturve dhe një pako e veçantë e masave për mbrojtjen e bashkësive dhe objekteve fetare. Krijimi i marrëdhënieve të mira ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, dhe brenda rajonit duhet po ashtu të jenë pjesë e zgjidhjes së problemit.

Ministrat vinë në pah se dispozitat efikase për decen-

tralizimin e qeverisë do të jenë kryesore për zgjidhjen e statusit. Ngase decentralizimi do të bëjë të mundur që komunitetet minoritare të mbeten pjesë vitale e së ardhmes së Kosovës dhe që njëherit të nxisin kthimin e personave të zhvendosur, të cilët do të mund të zgjedhin se ku dëshirojnë të jetojnë në Kosovë. Ministrat i bëjnë thirrje partive që të angazhohen seriozisht rreth kësaj çështjeje.

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, tok me të gjitha komunitetet e Kosovës, duhet të bëjnë më shumë, që të sigurojnë zbatimin e standardeve të miratuara nga Këshilli i Sigurimit të KB-ve. Përkushtimi i tyre është vendimtar për zgjidhjen e qëndrueshme të statusit, që do t'ia bëjë të mundur të gjitha

Zëri autentik i përfaqësuesve

Sabri Hamiti, kryetar i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritime Euroatlantike të Kuvendit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës

Përkufizimi restriktiv i funksioneve të institucioneve të Kosovës në Kornizën Kush-tetuese e ka bërë edhe më të ngushtuar hapësirën e këtyre institucioneve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në mënyrë të përpjestueshme në këtë gjendje është zvogëluar mundësia e mbrojtjes së interesave të Kosovës jashtë, e sidomos e mbrojtjes të qytetarëve që jetojnë jashtë, të gjendur thua ja të pambrojtur.

Kompetencat e Kryetarit të Kosovës në politikën e jashtme janë të kufizuara. Qeveria nuk ka ministri të jashtme.

Në këtë situatë, Kuvendi i Kosovës, si institucioni më i lartë përfaqësues, ka marrë mundin që të gjejë forma e të marrë edhe rolin e vet në fushë të bashkëpunimit ndërkombëtar. Kjo është bërë kryesisht nëpërmjet kontakteve të Kryetarit të Kuvendit apo të Kryesisë, e në mënyrë

të veçantë nëpërmjet Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritime Euroatlantike të Kuvendit të Kosovës.

Pra, ka mbetur që duke kaluar nëpër mungesa e pengesa të provohen kontaktet e vërteta e të drejtpërdrejta me botën e jashtme.

Mungesat janë të natyrës së brendshme dhe lidhen me mangësitë e mëdha në organizimin profesional e infrastrukturor të komisioneve të Kuvendit.

Pengesat janë të natyrës së pastër politike, meqë UNMIK, duke ruajtur rolin e qeverisjes në Kosovë, punët e jashtme i ka rezervuar për veten, duke mos krijuar asfarë lehtësime për kontakte të veçanta parlamentare, qeveritare e presidenciale.

Prandaj, aktiviteti i jashtëm i Kuvendit dhe i Komisionit është bërë mision i vështirë, gati i pamundshëm.

Në anën tjetër, kontaktet e rralla që kemi arritur të krijojmë me botën e jashtme dëshmojnë se sa e rëndësishme është prania e ligjënesve të Kosovës jashtë për të dëshmuar për ndodhjet dhe për synimet e Kosovës. Nga mosprania jonë e drejtpërdrejtë në këto relacione janë krijuar pamje të shtrembëruara për Kosovën, janë dhënë informata të pavërteta, të cilat i kanë pasuar edhe komentet e paargumentuara. Këto situata i kemi hasur qoftë në tubime parlamentare rajonale, qoftë në takimet parlamentare në Bundestagun gjerman, në Asambleenë franceze, madje në Kuvendin e Shqipërisë.

Në vitin 2006, që është përcaktuar si vit i negociatave për definimin e statusit politik të Kosovës, që për popullin e Kosovës është pavarësia e plotë, Kuvendi duhet të marrë një rol dinamik edhe në planin e bashkëpunimit

ndërkombëtar.

Një rol të madh të dinamizimit të këtyre marrëdhënieve do ta marrë sidomos Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritime Euroatlantike i Kuvendit të Kosovës. Madje i gjithë aktiviteti i tij kryesor do të orientohet në punët rreth pavarësisht të Kosovës, sidomos në kontaktet me SHBA dhe me Bashkimin Evropian, që pretendon të marrë një rol më substancial në zhvillimet politike dhe ekonomike në Kosovë në udhën e saj të integritimeve evropiane.

Jemi të bindur që vetëm zëri autentik i institucioneve të Kosovës do të artikulojë në mënyrë të qartë, të nevojshme e të domosdoshme vullnetin, nevojat dhe synimet e qytetarëve të saj. Ndërmjetësit, sado dashamirës qofshin ata, nuk e kanë as mundësinë as kapacitetin që ta kryejnë këtë detyrë.

Prandaj, presim që në këtë vit do të rritet roli i Kuvendit të Kosovës, e në mënyrë të veçantë roli i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në përfaqësimin e interesave të vendit përballë botës së jashtme. Kjo arrihet më së miri nëpërmjet institucionalizimit të raporteve me komisionet homologe dhe me asocimin e Kuvendit të Kosovës në institucionet parlamentare evropiane.

Për këtë duhet punë, kurajo e mbështetje nga miqtë e dashamirët e këtij vendi, që po rriten dhe pritet se do të rriten.



Nga e majta në të djathtë; gjatë një mbledhjeje të Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritime Euro-Atlantike të Kuvendit të Kosovës; Fatmir Sejdiu, Bajram Rexhepi, Sabri Hamiti, Mahir Yagcilar, Alush Gashi.

Prespektivë Evropiane për Kosovën

Institucionet dhe forcat politike vendore dhe faktorët e qendrave ndërkombëtare të vendosjes të gjendur para një përgjigje të vonuar për statusin politik të Kosovës, i cili mbase pritet të zgjidhet gjatë vitit 2006, përmes një diplomacie fluturuese, nuk do ta kenë edhe aq të lehtë ta bindin Beogradin zyrtar për ti akceptuar realitetet e reja jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon dhe më gjerë; por edhe as tua imponojnë shqiptarëve të Kosovës ndonjë ofertë e cila nuk është në përputhje me vullnetin e tyre politik.

Gjergj Dedaj, Deputet i Kuvendit të Kosovës, Partia Liberale e Kosovës (PLK)

Një e metë serioze e liderëve institucional dhe qeveritar të Kosovës është mungesa e traditës për shtetbërje dhe udhëheqje me punët shtetërore të cilën e trashëgojnë nga e kaluara historike kur shqiptarët ose ishin vasal të pushtuesve, në shërbim të tjerëve apo të zgjedhur nga vetë pushtuesit për ta drejtuar ndonjë institucion apo funksion sipas diktateve nga lart.

Mungesa e tillë e përvojës dhe frustrimet e së kaluarës pa dyshim se dëmtojnë jo vetëm imazhin e Kosovës por edhe perspektivën Evropiane dhe demokratike të saj ngase vendi edhe pse shtatë vite pas konfliktit po drejtohet me metoda arriviste, nepotiste, klanore dhe herë-herë bolshevike.

Liderët institucional dhe Ministrat e Qeverisë së Kosovës e kanë personalizuar dhe madje banalizuar përgjegjësinë e tyre ndaj elektoratit kosovar të cilit i kishin ofruar gjatë fushatave zgjedhore një katalog të tërë premtimesh për vitin 2005, premtime këto të cilat dolën se ishin vetëm mashtrime dhe togje fjalësh të mësuara përmendësh dhe të thëna me gojë ose me shkrim para elektoratit kosovar i cili ende nuk tregoj maturinë e duhur dhe ta tejkaloj logjikën e mitologjisë lideriste dhe të rreshtohet afër veprave dhe programeve e jo pranë liderëve dhe premtimeve megalomane dhe historike të forcave të ndryshme politike.



Gjergj Dedaj

Perspektiva Evropiane e Kosovës nuk duron këtë mentalitet të sundimit mbi institucionet e Kosovës sikur të ishin pronë private e liderëve dhe qeveritarëve tanë por ajo perspektiv duhet të bazohet mbi reformat rrënjësore të këtij mentaliteti i cili është bërë pengesë serioze e rrugëtimit evropian të Kosovës dhe krijimit të shanseve për integritet euro-atlantike, sundimin e ligjit, ekonominë e tregut të lirë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të bashkësive etnike, lëvizjen e lirë, barazi gjinore, luftimin e krimit dhe korrupsionit si dhe shumë dobësive tjera të cilat janë bërë pengesa serioze të kësaj perspektive dhe synimi për një Kosovë vërtetë

demokratike dhe Evropiane.

Edhe formimi i Grupit Negociator dhe atij Politik nuk dëshmoj gjerësinë dhe pjekurinë e klasës udhëheqëse politike e cila mbetet gjenerator i krizës aktuale në Kosovë dhe pengesë për integrimin e bashkësive të ndryshme etnike në shoqërinë dhe politikën e Kosovës mu për shkak të mentalitetit të degraduar dhe mos aftësisë së daljes nga gëzhoja klanore dhe partiake e shumicës së liderëve kryesor të Kosovës disa nga të cilët janë aty aksidentalisht, disave iu ka prirë fati dhe ka nga ata të cilët kanë ditur të notojnë mbi meritat e të tjerëve dhe në momentet e caktuara të sulmojnë si peshaqenë në pikë të ditës nga

uria dhe epshi për kafshim.

Sido qoftë nëse arrihet zgjidhja e statusit politik të Kosovës deri në qershor të këtij viti siç po premtojnë liderët kosovar kjo nuk do të thotë se i është vënë pikë problemeve në Kosovë dhe rreth sa, por pikërisht kjo nënkupton një fillim të ri dhe të bazuar tërësisht mbi reformat e thella demokratike të cilat do të mundësojnë plotësimin e standardeve evropërendimore dhe nisjen e procedurave për perspektivën Evropiane të Kosovës, e cila fillimisht do të gëzonte statusin e anëtarit për kandidim në BE dhe mekanizmat tjerë duke dhënë e kuptuar se ato nuk mund të vijnë si dhurata por duhet të meritohen dhe arrihen me përkushtim, përgjegjësi dhe angazhim të palodhshëm të tërë strukturave udhëheqëse kosovare në të gjitha fushat e jetës.

Me zgjidhjen e statusit final politik të Kosovës do të duhej të shpallen zgjedhjet e përgjithshme duke krijuar një fushatë të shanseve të barabarta për forcat politike dhe kështu të arrihen reformat dhe ndryshimi i gjeografisë dhe konfiguracionit politik aktual i cili si i tillë në Kosovë tashmë është bërë pengesë e vetvetes por edhe i ka mbyllur dhe ngulfatur proceset demokratike në Kosovë ngase me të njëjtat subjekte dhe me të njëjtit individ në pushtet Kosova do ta ketë të vështirë perspektivën e saj demokratike dhe Evropiane.

E drejta e komunitetit turk për përdorimin e gjuhës

Mahir Yagcilar, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP)



Mahir Yagcilar

Së shpejti pritet miratimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhës në Kosovë. S'ka pikë dyshimi se ky ligj ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për ardhmërinë e të gjitha komuniteteve të Kosovës. Nëse vërtetë dëshirojmë të ndërtojmë një shoqëri shumë-etnike dhe shumëgjuhësore, me fjalë të tjera nëse dëshirojmë që pos shqiptarëve dhe serbëve të ekzistojnë edhe komunitete dhe gjuhë të tjera, atëherë ky ligj duhet të hartohet me shumë kujdes.

Sipas këtij draftligji, gjuha turke dhe gjuhët e tjera të minoriteteve mund të jenë gjuhë zyrtare në ato komuna ku popullata e tyre përbën më shumë se 6 % të popullatës së përgjithshme të asaj komune. Megjithatë, një kufizim i këtillë nuk mund të haset as në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve të vitit 1977, as në

Kushtetutën e Kaçanikut e as në Kornizën Kushtetuese. Si ligji për përdorimin e gjuhëve aktualisht në fuqi është Ligji i Rajonit Autonom të Kosovës, i cili në pjesën hyrëse thotë se: "Komuniteti turk, i cili banon në rajone të caktuara të Kosovës, ka të drejtë ta përdorë gjuhën turke dhe alfabetin turk në mënyrë të barabartë." Së këndejmi, konform kësaj dispozite, e drejta për përdorimin e gjuhës turke në institucionet arsimore dhe gjyqësore si dhe në fusha të tjera është njohur haptazi.

Nëse e shikojmë Kornizën Kushtetuese ajo i njeh shqipen dhe sërbshten si gjuhë zyrtare. Mirëpo, sipas nenit 4.4 të Kornizës Kushtetuese, "Komunitetet kanë të drejtë ta përdorin lirisht gjuhën dhe alfabetin e tyre si në gjyqe, asociacione ashtu edhe në institucione të tjera të Ko-

sovës." Njëherësh, një gjë e këtillë është parashikuar edhe me nenet e tjera. Ndërsa, përdorimi i gjuhëve në institucionet komunale është rregulluar me nenin 9 të Rregullores 2000/ 15 të UNMIK-ut, e cila thekson se: "Në komuna ku jetojnë një numër i konsiderueshëm i komuniteteve të tjera, të gjitha dokumentet zyrtare duhet të lëshohen edhe në gjuhën e tyre." Një praktikë e ngjashme është parashikuar edhe në Dokumentin mbi Implementimin e Standardeve.

Meqë të gjitha ligjet duhet të jenë në pajtim me Kornizën Kushtetuese, unë besoj që me rastin e përgatitjes së draftligjit për Përdorimin e Gjuhëve kjo çështje është dashur të merret parasysh patjetër.

Draftligji për Përdorimin e Gjuhëve nuk e lejon përdorimin e gjuhëve të tjera, pos shqipes dhe sërbshtes. Ndërsa, për t'u njohur si gjuhë zyrtare në nivelin lokal grupi duhet të përbëjnë jo më pak se 6 % të popullatës së tërësishme të atyre komunave, e drejta për të përdorur gjuhët e komuniteteve para autoriteteve të komunës i nënshtrohet kufirit të 3 %-it. Së këtejmi, nëse komisionet e Kuvendit nuk i hartojnë rregulloret në bazë të këtyre kriterëve, atëherë unë kujtoj se ky ligj do të jetë në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese. Fjala vjen, neni 3.4 i draftligjit është në shpërputhje me nenin 4.4 të Kornizës Kushtetuese. Ndaj, nëse ky ligj miratohet në këtë formë nga Kuvendi i Kosovës, atëherë ky do të jetë

ligji i parë që i shkel të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Gjatë leximit të parë të këtij ligji në Komisionin përgjegjës, është mbajtur një ndër diskutimet më kontraverze, ndërsa më pas është mbajtur edhe një diskutim publik. Ndonëse kohëve të fundit, autoritetet e UNMIK-ut intervenuan duke dërguar dy letra, njërën e dërgoi PSSP-ja, ndërsa tjetrën Këshilltari për Çështje Ligjore, ku shpreheshin pikëpamje të ndryshme, asgjë nuk është arritur që 8 muaj. Ne jemi të vetëdijshëm se ky ligj është i lidhur me vlerësimin e standardeve, mirëpo nëse ka kufizime të të drejtave për përdorimin e gjuhës së komuniteteve të tjera për shkak të implementimit të standardeve, atëherë standardet e tjera do të shkilen.

Në Kosovë, pos shqipes dhe sërbshtes, përdoren edhe gjuhë të tjera. Megjithatë, në asnjë nen të draftligjit nuk përmenden gjuhët e tjera. Në Kornizën Kushtetuese, pos komunitetit shqiptarë dhe sërbe, përmenden edhe turqit, boshnjakët, goranët, ashkalinjtë dhe romët. Gjerë më tani nuk ka pasur ndonjë kërkesë të veçantë sa i takon gjuhës nga ana e komunitetit romë dhe ashkalinjë, ngase ata gjuhën shqipe e kanë gjuhë amëtare dhe shkollohen në gjuhën shqipe. Komuniteti Goran e flet gjuhën serbe dhe shkollohet në gjuhën serbe. Romët në përgjithësi në shkollë e përdorin gjuhën shqipe, por në të njëjtën kohë, ndonëse në mënyrë të kufizuar, ata e përdorin edhe gjuhën serbe, boshnjake dhe turke, por ata kanë kërkuar që gjuha rome të përfshihet si gjuhë shtesë.

Kërkesat e boshnjakëve janë mjaftuar me përdorimin e gjuhës boshnjake.

Duke i mbajtur parasysh të gjitha këto fakte, dispozitata e draftligjit për përdorimin e gjuhëve do të ndikojnë më së tepërmi në përdorimin apo mospërdorimin e gjuhës turke. Askush nuk mund të dijë se në cilën komunë përdorimi i një gjuhe do të jetë në gjendje ta përmbushë kriterin e 3 %-it apo 6 %-it përpara se të dihen rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe decentralizimit. Draftligji mbi Përdorimin e Gjuhës duhet të harmonizohet

me Kornizën Kushtetuese dhe me ligjet e tjera në fuqi. Së këndejmi, do të ishte gabim shumë i madh nëse do të përcaktohej përdorimi zyrtar i gjuhëve sipas përqindjes, përpara se të kryhet regjistrimi dhe decentralizimi.

Për mbijetesën e gjuhëve është me rëndësi që të bëhen hulumtime rreth gjendjes së tyre në terren. Pos serbishtes dhe shqipes, ne duhet të përpiqemi t'i mbajmë gjallë edhe gjuhët e tjera sepse ato para së gjithash duhet të konsiderohen si begati e Kosovës. Prandaj, roli dhe përgjegjësia

e akterëve ndërkombëtarë, UNMIK-ut dhe institucioneve të Kosovës është i një rëndësie të veçantë për t'i mbajtur këto gjuhë të gjalla.

S'do mend se kjo çështje për komunitetin turk ka një rëndësi të veçantë. Ngase komuniteti turk beson se me ruajtjen e të drejtave të tyre gjuhësore, ata do ta ruajnë edhe identitetin dhe vlerat e komunitetit të tyre. Kërkesa e komunitetit turk sa i takon përdorimit të gjuhës së tyre është që të sigurojë status të njëjtë të gjuhës turke me gjuhët e tjera, në komunitat ku jetojnë.

Kujtojmë se kjo e drejtë tanimë është siguruar. Gjuha turke është në përdorim në disa qytete të Kosovës - në Prizren, Gjiilan, Prishtinë, Vushtrri, dhe Mitrovicë. Këto janë komunitat ku turqit kanë jetuar dhe e kanë përdorur gjuhën e tyre tradicionalisht.

Ne jemi koshient se çështja e përdorimit të gjuhës është një çështje shumë e ndjeshme, ndaj dëshiroj të vë në dukje se në të ardhmen duhet të punojmë rreth kësaj çështje dhe implikimeve të saj me më shumë mirëkuptim dhe në mënyrë më kualitative.

Zhvillimet e fundit në Kuvend

ORA kërkon seancë të veçantë të Kuvendit

Me 7 nëntor 2005, grupi parlamentar ORA dorëzoi, tok me 40 nënshkrime të deputetëve që mbështesnin këtë iniciativë, një mocion për seancë të jashtëzakonshme plenare për të diskutuar (1) mënyrën se si është marrë vendimi për të ndërtuar "Qendrën Administrativo - Protokollare" në parkun e Gërmisë dhe (2) shpenzimet e buxhetit të Kuvendit gjatë pjesës së parë të vitit 2005. Sipas mocionit, arsyet kryesore për thirrjen e seancës së veçantë janë nevoja për të përcaktuar dhe konstatuar nëse ka pasur parregullësi procedurale jo vetëm gjatë procesit të vendim-marrjes por edhe gjatë alokimit të fondeve të Kuvendit për shpenzime kapitale dhe shpenzime të tjera. Këto pika ishin parashikuar të diskutoheshin gjatë seancës plenare me 24 janar 2006. Mirëpo, për shkak të vdekjes së Presidentit Rugova me 22 janar, debati është shtyer për muajin shkurt.

Kuvendi miraton legjislacion të ri

Gjatë seancës plenare të 15, 16 dhe 19 nëntorit 2005, Kuvendi miratoi pas leximit të dytë Draftligjin për Gjueti, përfundoi me leximin e parë dhe të dytë të Propozimit për Miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Autorizimin e Shpenzimeve për vitin kalendarik 2006. Po kështu, Kuvendi miratoi gjatë leximit të parë Draftligjin mbi Veprimtarinë Botuese dhe Librin, Draftligjin për Institucionet e Kulturës, Draftligjin për Arsimin Privat dhe Trajnimin, Draftligjin për Operan, Baletin dhe Filharmoninë e Kosovës, Draftligjin mbi Lirinë e Anëtarësimit në Sindikata, dhe Draftligjin mbi Inspektoratin për Produkte Ndërtimore.

Njëherit, gjatë sesionit plenar të 19 dhe 20 janarit 2006, Kuvendi miratoi pas leximit të dytë Draftligjin mbi Inspektoratin Shëndetësor, Draftligjin mbi Arsimin Parashkollor, Draftligjin për

Miniera dhe Minerale, Draftligjin për Metrologji, Draftligjin për Radio Televizionin e Kosovës, dhe Draftligjin për Draftligji për Provimin e Jursiprudencës. Pos këtyre, Kuvendi miratoi pas leximit të parë Draftligjin për Ndërmjetësim, Draftligjin mbi Konfliktin Administrativ, Draftligjin për Shpifje dhe Fyerje dhe Draftligjin për Ditën e Heronjëve.

Grupi i ri parlamentar "Për Integrim"

Deputetët e gjashtë partive të vogla politike vendosën të themelojnë një grup të ri parlamentar "Për Integrim". Anëtarët e këtij grupi janë z. Ferid Agani (PD - Partia e Drejtësisë), z. Gjergj Dedaj (PLK - Partia Liberale e Kosovës), z. Sabit Rrahmani (PDAK - Partia Demokratike e Ashkalinjëv të Kosovës), z. Numan Balić (SDA - Partia për Aksion Demokratik), z. Rustem Ibishi (GIG - Iniciativa Qytetare e Gorës), dhe z. Zylfi Merxha (PReBK - Partia e Romëve të Bashkuar të Kosovës). Me këtë rast, z. Agani e njoftoi Kryesinë e Kuvendit se fillimisht ai do të shërbejë si udhëheqës i grupit parlamentar për tre muajt e parë, ndërsa më pas do të aplikohet parimi i rotacionit për të gjithë anëtarët e grupit. Po kështu, ata janë dakorduar me udhëheqjen e Kuvendit lidhur me pjesëmarrjen si në debatet e seancave plenare ashtu edhe në mbledhjet e komisioneve.

Anëtarët e ri të Kuvendit të Kosovës

Bazuar në parimin e rotacionit brenda grupit parlamentar "6+," në seancën plenare të Kuvendit mbajtur me 15 dhe 16 dhjetor 2005 u përkrah emërimi i z. Mahir Yagcilar (6+/KDTP) për anëtar të ri të Kryesisë së Kuvendit, për ta zëvendësuar z. Xhezair Muratin (6+/Vakat), i cili u bë anëtar i ri i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Euro-Atlantike.

Zbatueshmëria e ligjeve

Wolff-Michael Mors, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, Misioni i OSBE-së në Kosovë



Aktiviteti legjislativ në Kosovë, në pesë vitet e fundit ka rezultuar me miratimin e një numri të madh të rregulloreve të UNMIK-ut dhe ligjeve të Kuvendit të Kosovës, të cilat rregullojnë një gamë të gjërë të marrëdhënieve shoqërore. Nevoja për hartimin e ligjeve të reja është theksuar vazhdimisht, si nga ana e përfaqësuesëve të administratës ndërkombëtare ashtu edhe nga qytetarët e Kosovës, në mënyrë që të tejkalohen boshllëqet ekzistuese ndërmjet legjislacionit të trashëguar jugosllav dhe realitetit të ri social, ekonomik dhe politik. Së këndejmi, një pjesë e konsiderueshme e resurseve të administratës ndërkombëtare dhe të IPVQ-ve, i është kushtuar arritjes së këtij qëllimi, ndaj dhe rezultatet e këtyre aktiviteteve mund të konsiderohen si të arritura të rëndësishme.

Sikundër edhe shumë parlamente të tjera, Kuvendi i Ko-

sovës nuk ka pasur as kohë e as ekspertizën e duhur për t'i shqyrtuar detajisht normat ligjore për rregullimin e çështjeve të ndryshme. Kështu që autorizimi për hartimin e rregulloreve dhe dokumenteve të tjera lidhur me këto çështje iu delegohet rregullisht ministrave. Megjithatë, për parimin i ndarjes së pushtetit nevojitet ekzistimi i autorizimeve për nxjerrjen e legjislacionit subsidiar, autorizime këto që me ligj të parlamentit veçanërisht i jepen organit gjegjës.

Në praktikë, ligji zakonisht reflekton vendimet politike dhe e përcakton strukturën e vetë lëndës. Ndërsa, më së paku që mund të bëjë është të ofrojë një kornizë ligjore. Hollësitë e veprimit të ligjit shpeshherë përcaktohen nga instrumente të ndryshme të natyrës teknike, që shëndrrohen në ligje të dorës së dytë, karshi vendimit të marrur nga parlamenti. Nocioni "zbatim"

në kuptimin e mirëfilltë të tij, domethënë "plotësim (i boshllëkut)", në mënyrë që me një udhëzim administrativ, boshllëku i lënë nga Kuvendi të plotësohet me legjislacion sekondar nga organi përgjegjës ekzekutiv. Së këndejmi, disa ligjeve para së gjithash u nevojitet një legjislacion sekondar, në mënyrë që të bëhen të realizueshme dhe të zbatueshme.

Legjislacioni subsidiar (plotësues) hyn në fuqi sikur të ishte pjesë e ligjit themelor, d.m.th, ka fuqi ligjore. Është mjet përmes të cilit, ekspertët në mbulimin e lëndës përmes ligjit, mund ta përmirësojnë vargun e masave, duke bërë të mundur zbatimin praktik të ligjit themelor. Parlamenti as nuk mund ta parashikoj çdo mundësi dhe as nuk ka ekspertë të veçantë, që do të mund të siguroheshin qoftë përmes ministrive apo edhe

përmes agjencive. Nëse, kompetenca e dhënë nga akti burimor është e mjaftueshme dhe ligjore, atëherë legjislacioni subsidiar mund të merret me elaborimin praktik të problemeve, detajeve teknike apo nevojën për informatat e azhurnuara kur një nevojë e tillë paraqitet, duke i adresuar ato përmes kategorive të përcaktuara, në mënyrë hierarkike, të akteve subsidiare. Marrë në përgjithësi, ekziston mundësia që të nxirret më shpejtë legjislacioni subsidiar se sa të miratohet legjislacioni primar, ngase për qëllimin dhe parimin e ligjit tanimë është rënë dakord. Për më tepër, vetë legjislacioni subsidiar mund të tërhiqet apo amendamentohet, nëse dëshmohet të jetë i pazbatueshëm apo edhe nëse ndryshojnë rrethanat. Kohë pas kohe, legjislacioni burimor mund të rihartohet tok me ndonjë amendamentim, që të hartohet si pjesë e legjislacionit zëvendësues.

Misioni i OSBE-së në Kosovë, përmes sektorit për Sundim të Ligjit, ka publikuar në dhjetor të vitit 2005, raportin e dytë mbi "Zbatimin e Ligjeve të Kuvendit të Kosovës" duke vlerësuar kryesisht Ligjet e Kuvendit të Kosovës, të shpallura në vitin 2004.

Marrë në tërësi, OSBE-ja ka konstatuar se shumica e ministrive vazhdojnë të bëjnë përparime të konsiderueshme në hartimin e legjislacionit subsidiar. Fjala vjen, Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji kanë faktuar se janë shumë të suksesshme dhe të organizuara në këtë drejtim. Mirëpo, nga ana tjetër, ka mjaft vend për

përmirësime në disa ministri dhe në Qeveri. Në shumicën e rasteve, akterët nuk ia kanë dalur mbanë që t'i përmbahen afateve të parashikuara për miratimin e akteve sekondare. Huluntimi vijues, sipas raportit të fundit, po ashtu e bënë të qartë, që disa ligje të periudhës 2002–2003 ende nuk janë zbatuar në masën e paraparë nga Kuvendi, pavarësisht nga përparimet e shënuara në disa ministri.

Të dhënat provojnë se sa i takon së paku disa ligjeve, nuk është bërë asgjë ose është bërë shumë pak drejt zbatimit, ndonëse shpeshherë ndodh që të kërkohet legjislacioni sekondar në mënyrë që Ligji të bëhet një dokument i zbatueshëm. Fjala vjen, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit, Mbrojtjen e Konsumatorit, Patentim dhe Konkurrencë (nga viti 2004), të gjitha kanë mbetur të pazbatuara. Ndonëse, ligjet e vitit 2003 ai për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Ligjor në Falimentim dhe për Aktivitetet e Jashtme Tregtare, kërkojnë një sërë aktesh shtesë për t'u bërë të zbatueshme, megjithatë ende pothuajse asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Së këtejmi, si Kuvendi ashtu edhe Qeveria, duhet të ndër marrin masa për adresimin dhe plotësimin e menjëherëshëm të boshllëqeve të këtilla. Mbase, në ca raste, nga pikëpamja e sundimit të ligjit, është më keq të kemi ligje të pazbatueshme se sa të mos kemi ligj fare.

Pos analizës ligj për ligj, raporti merret edhe me shqyrtimin e aspekteve normative dhe funksionale të zbatimit të ligjeve. Informatat janë marrë përmes një huluntimi plotësues, të zhvilluar nga OSBE-ja në zyrat ligjore të ministrive, me qëllim që të kuptohet jo vetëm se si koordinohet dhe organizohet hartimi i legjislacionit sekondar,

por edhe cilat janë vështërsitë dhe mangësitë sa i takon qartësisë së sistemit, resurseve apo ekspertëve. Vështirësitë rreth zbatimit të ligjeve janë pjesërisht pasojë e ministrive dhe Qeverisë, të cilat i japin përparësi hartimit të legjislacionit primar ndaj atij sekondar. Për më tepër, mungesa e kuadrove dhe ekspertizës ligjore në zyrat e ndryshme ligjore ka bërë që këto çështje të jenë prioritet. Megjithatë, krahasuar me vitin e shkuar gjendja sa i takon rekrutimit të stafit në shumicën e zyreve ligjore ka ardhur duke u përkeqësuar.

Raporti përmbillet me një varg rekomandimesh, me të cilat adresohen fusha të ndryshme të ciklit implementues. Përveç sugjerimeve të reja, në raport përsëriten disa prej rekomandimeve nga versioni i parë, p.sh. mekanizmi i dyfishtë mbikqyrës, që duhet të krijohet,

në mënyrë që të sigurohet zbatimi i ligjeve. Nga njëra anë, Kuvendi i Kosovës duhet ta shqyrtojë mundësinë e krijimit të mbikqyrjes parlamentare në baza periodike, duke përfshirë këtu edhe prezencën e rregulltë të qeveritarëve në komisionet e Kuvendit, dhe njëherazi të kërkojë nga ZKM-ja përgatitjen e raportit vjetor për procesin e implementimit. Nga ana tjetër, Qeveria duhet ta themelojë një mekanizëm mbikqyrës me pika fokale në secilin institucion ekzekutiv. Në këtë kontekst, rregulloret qeveritare, të lëshuara në vitin 2005, janë një fillim i mbarë.

Tutje, raporti rekomandon, që Kuvendi i Kosovës dhe Zyrja e PSSP-së që të arrijnë një marrëveshje për procedurën përmes së cilës ndryshimet e bëra nga një Rregullore e UNMIK-u, të përfshihen në tekstin e ligjit përkatës të Kuvendit, në mënyrë që të shmaget kon-

fuzioni në përmbajtjen e ligjit.

Zyrtarët, të cilët i hartojnë dhe miratojnë ligjet duhet të jenë të përpiktë, kur japin autorizime për përgatitjen e legjislacionit sekondar. Sa herë që propozimligji parasheh, që çështjet e veçanta të rregullohen me akte nënligjore, ligji i propozuar duhet po ashtu të përmbaj autorizimin e qartë për hartimin dhe nxjerrjen e akteve të tilla, dhe njoftim të qartë mbi pikënisjen themelore. Për të mbështetur më tutje këtë proces, si akterët vendor ashtu edhe ndërkombehtarë duhet të ofrojnë dhe mbështesin vazhdimisht kurse të mirëfillëta jo vetëm për hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar, por edhe për menaxhimin e rregulloreve. Kjo do të mund të kombinohej me trajnime pa shkëputje nga puna mbi hartimin e akteve subsidiare, në mënyrë që të sigurohet përparim në punë.

Prezantimi i raportit mbi zbatimin e ligjeve në Kuvend

Me 18 janar 2006 Misioni i OSBE-së në Kosovë u takua me disa kryetarë të komisioneve dhe kryesues të grupeve parlamentare për të diskutuar rreth raportit të dytë mbi zbatimin e ligjeve të Kuvendit. Raporti merret me vlerësimin dhe shqyrtimin e ligjeve, të cilat janë miratuar gjatë vitit 2004 dhe konstaton se ende ka problemet serioze jo vetëm me kapacitetet legale të ministrive por edhe me publikimin e pamjaftueshëm të akteve ligjore. Ndërsa, gjatë diskutimit rreth dokumentit, deputetët e Kuvendit shprehën vlerësimin e tyre për raportin, kritikuan mungesën e bashkërendimit midis Kuvendit, qeverisë dhe në veçanti Zyrës Ligjore të KB-ve dhe njëherit shprehën shqetësimin e tyre lidhur me mospërputhjet në rritje të kornizës ligjore. Së këndejmi, u ra dakord që Kuvendi e në veçanti komisionet ta shtojnë mbikqyrjen e qeverisë lidhur me zbatimin e ligjeve. Ndërkaq, OSBE-ja i ofroi kryetarëve të komisioneve që t'i vizitojë komisionet e tyre individualisht për të diskutuar rreth çështjeve dhe problemeve të veçanta lidhur me mbikqyrjen parlamentare dhe zbatimin e ligjeve në sektorët që i mbulojnë ata.



Zyra e Auditorit të Përgjithshëm – shtylla qëndrore për përgjegjshmërinë publike

Në shoqërinë moderne dhe demokratike, institucionet mbajnë përgjegjshmëri përmes sistemit të kontrollit dhe balancit. Katër lëmitë kryesore të sistemit të kontrollit dhe balancit janë: (1) Qeveria, ku Egzekutivi nevojitet të themeloj një strukturë të kontrollit financiar, të siguroj që autoritetet sipas raportit nën jurisdiksionin e tyre të realizojnë buxhetin në mënyrë e paramenduar; (2) Tregu, ku shteti nevojitet t'i organizoj dhe zbatoj parakushtet për një funksionim të mirë të tregut dhe të mbroj anën e të hyrave të buxhetit shtetëror; (3) Sistemi Gjyqësor, të siguroj një funksionim të mirë të Zbatimit të Ligjit dhe Sistemit Gjyqësor; dhe në fund (4) Parlamenti, që duhet ta vë në funksion sistemin auditorë të jashtëm për përcaktimin e asaj se nëse Qeveria ka paraqitur dhe ka realizuar buxhetin sipas kërkesës, dhe sipas kontrollit të mirë të brendshëm dhe në mënyrë të ligjshme.

Serafim Sofroniev, Zëvendës i Auditorit të Përgjithshëm

Pra, është e qartë që Legjislatura ka nevojë për funksione të ndryshme, që t'u ndihmohet atyre me vazhdueshmërinë e asaj nëse Egzekutivi i zbaton apo jo vendimet e marra nga Legjislatura sipas kërkesave. Legjislatura poashtu duhet të mbajë përgjegjësinë për Egzekutivin përmes shkeljetve etj. Një funksion i rëndësishëm në këtë është Institucioni Suprem Revizionist-Auditor.

Rëndësia e funksionimit të mbikqyrjes së mirë të Kuvendit dhe Institucionit Auditor Suprem efikas është njohur me propozimin për Partneritetin European – baza për programimin e asistencës financiare të komunitetit – si parim dhe kusht.

Deklarata INTOSAI nga viti 1977, është bazë e përbashkët për rolin, mandatin dhe detyrën e Institucionit Auditor Suprem. Sipas deklaratës, parakusht bazë për funksionimin e mirë të Revizionimit është e mjaftueshme Korniza Ligjore, që i garanton Institucioneve Auditore Supreme pavarësi nga të dyja palët nga autoriteti Egzekutiv dhe Legjislatura. Kjo njihet ndërkombtarisht si karakteristikë e domosdoshme për mirëbesim në Institucionin Auditor Suprem.

Si pjesë e deklaratës INTOSAI, që Institucioni Auditor Suprem të punojë mirë, duhet ta përmbush rolin e tij si një Institucion Kontrolli i Pavarur i Ekonomisë dhe Informator i punës, duke u përqëndruar në efikasitetin e shpenzimeve publike, duke patur parasysh zinxhirin e komandimit: Agjencinë Egzekutive, përmes Ministrisë përkatëse gjer në Qeveri, duke përfunduar në Kuvend.

Më tutje, Institucioni Auditor Suprem duhet t'i avancojë standardet më të larta me transparencë, përgjegjshmëri dhe integritet në menaxhimin financiar dhe performancën e administratës publike, dhe të ketë sistem të zhvilluar mirë dhe të ndjek procedurat, në mënyrë që t'i siguroj veprimet e ndërmarruna mbi të gjeturat auditore dhe rekomandimet nga palët në fjalë; pala që auditohet, Qeveria dhe Kuvendi.

Zyrja e Auditorit të Gjithmbarshëm është themeluar në vitin 2003. Bashkësia Europiane, Shtylla IV e UNMIK-ut dhe Agjencioni European për Rindërtim (AER), mbështet fazën e parë të këtij zhvillimi, që do të finalizohet në mes të vitit 2006. Një pjesë e rëndësishme e projektit të tanishëm është

hartimi i Ligjeve mbi Revizionin e Jashtëm të Sektorit Publik në Kosovë. Mbështetja e jashtme parashihet për një periudë shtesë prej tre vjetësh, duke ndihmuar në zbatimin e parashikuar të ligjit të ri dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të Zyrës së Auditorit të Gjithmbarshëm. Atëherë, Auditori i përgjithshëm gradualisht do të marrë përsipër dhe ta realizoj auditimin me stafin vetanë.

Brenda dy viteve Zyrja e Auditorit të Përgjithshëm ka organizuar trajnime intenzive për rreth 60 rekrut auditorë. Zyrja në vitin 2005, ka ofruar auditor për prokurim dhe administrim të pasurisë në shumicën e komunave dhe në disa ministri. Më tutje, Zyrja e Auditorit të Përgjithshëm mori përgjegjësinë për auditorë të jashtëm për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, në vitin 2004 (BKK), duke angazhuar stafin më të kualifikuar për auditim, me mbështetjen e jashtme të konsiderueshme, nga Trupi i Auditorëve nga Holanda dhe nga këshilltarë auditor afatgjatë. Raporti Auditor për vitin 2004 të BKK është publikuar në shkurt të vitit të kaluar. Zyrja e Auditorit të Përgjithshëm ka synim imediat të organizoj auditim të jashtëm

të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, në kuadër të ciklit buxhetor për auditor të jashtëm për vitin 2005 të BKK.

Mbështetja e jashtme për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, duhet të bëjë auditimin e jashtëm të buxhetit të organizatave dhe Buxheti i Konsoliduar i Kosovës duhet që për tre vitet e ardhshme krahas gjërave tjera të zbatoj programe çertifikuese dhe më tutje t'i trajnoj auditorët në auditimin qeveritar poashtu edhe auditimin e sektorit publik.

Sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2002/18, në bazë të së cilës është themeluar Zyrja e Auditimit Gjeneral i raporton PSSP-së, si pjesë e kompetencave të rezervuara. Megjithatë, në të ardhmen Institucioni Auditor Suprem do të raportoj Kuvendit.

Auditori i Përgjithshëm dhe Usht-ruesit e Detyrës së Drejtorëve Vendor tashmë e kanë vizituar Kryetarin e Kuvendit dhe shumicën e Ministrive. Mbledhja, poashtu, është mbajtur me antarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në shtator të vitit 2005, ku udhëheqësia ndërkombtare prezantoi një pasqyrë të zhvillimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe raportim

auditimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2002 dhe 2003.

Krahas çështjeve të rëndësishme strategjike, që Kuvendi duhet t'i drejtohet në të ardhmen e afërt, kjo do të bëjë sigurimin e mjaftueshëm të kornizës ligjore rreth Institucionit Auditor Suprem, duke lejuar parakushtet më të mira të mundshme, për plotësimin e rolit dhe mandatit të saj. Më tutje, ka nevojë të vazhdohet ndërveprimi ndërmjet Kuvendit dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, në mënyrë që të gjenden format më efikase për mbështetjen e Kuvendit në mbajtjen e qeverisë të përgjegjshme për realizimin e buxhetit. Në fund, dialogu ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë duhet të përforcohet, poashtu duke i dhënë hapësirë dialogut në vijim të rekomandimeve nga raporti i Institucionit Auditor Suprem.

Disa mesazhe kyçe për Kuvendin dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, për sa i përket kësaj janë:

Kuvendi duhet t'i përmirësoj marrëdhëniet e punës me Institucionin Auditor Suprem dhe mbikqyrjen e aktiviteteve qeveritare duke përfshirë: (1) Përcaktimin e një Komisioni të Kuvendit, që të bëjë mbikqyrjen e financave të Institucionit Auditor Suprem (pa ndërhyrjen e qeverisë) dhe të shqyrtoj – por jo të dirigjoj punën e tij. Kuvendi duhet të siguroj, që vetë Institucioni Auditor Suprem të auditohet në mënyrë të pavarur, në përputhje me standardet e në zbatim; (2) Specifikimin e qartë të llojeve të raporteve auditore për prezentim në Kuvend, derisa në të njëjtën kohë të bëjë përzgjedhjen dhe lë çështjen e lirisë së veprimit Institucionit

Auditor Suprem; (3) Informimin e Institucionit Auditor Suprem për interesat e Kuvendit, duke përfshirë temat e sugjeruara auditore, pasi që njëkohësisht, vendimet përfundimtare bëhen sipas prioriteteve auditore ndaj Institucionit Auditor Suprem; (4) të vë rregulla për funksionimin e Komisioneve të Kuvendit dhe t'i pajisata me staf ndihmës adekuat, lidhur me punën e Institucionit Auditor Suprem dhe për mbikqyrjen e shpenzimeve të qeverisë; dhe përfundimisht (5) të siguroj që Komisioni i duhur i Kuvendit të merr kompetencë imediate për raportet auditore nga Institucioni Auditor Suprem.

Njëherit është me rëndësi, që Zyrja e Auditorit të Përgjithshëm të: (1) Shkruaj raporte auditimi të qarta dhe koncize, të drejta dhe të bazuara në fakte, duke iu shmangur deklaratave politike (2) Ti jep rëndësi të duhur dhe jo të jashtëzakonshme shqetësimeve të Kuvendit në vënien e prioriteteve auditore; (3) Të bëjë përzgjedhjen në vendosjen se cilin raport auditor, të ia dorëzoj Kuvendit, duke i dërguar vetëm këto raporte, të cilat e meritojnë qartë vëmendjen e Kuvendit dhe që përfshijn deklaratë të qartë se pse ai raport i dërgohet Kuvendit; dhe më në fund (4) Në mënyrë aktive dhe metodike të ndjek të gjeturat e mëparshme auditore dhe ta informoj kuvendin për çdo shembull mosveprimi mbi problemet e rëndësishme.

Me këtë përkushtim, do të themelohet një bazë e mirë, që do të ia mundësonte Institucionit Auditor Suprem t'i kontribuoj mbikqyrjes më të mirë të Kuvendit; zhvillimin e sistemit qeveritar të kontrollit dhe implementim efikas të buxhetit dhe politikave.

Përfundimi i projektit SPEAK

Krenar Loshi - UNDP dhe Ali Caka - Menaxher i Projektit SPEAK

Projekti për Mbështetjen e Arkivës Elektronike të Kuvendit, i inicuar para dy vitesh nga UNDP-ja dhe Unioni Ndër-Parlamentar, i cili tanimë është funksional, i është dorëzuar Sekretariatit të Kuvendit të Kosovës me 25 tetor 2005. Mirëpo, përfundimi i tërësishëm i projektit varet nga finalizimi i procedurave dhe rregulloreve që nevojiten për t'ia vënë publikut të gjerë në dispozicion arkivat elektronike.

Arkivat elektronike aktualisht janë të hapura vetëm për anëtarët e brendshëm dhe të ftuar të Kuvendit. Sistemi i ri për menaxhimin elektronik të dokumenteve është treguar jashtëzakonisht i dobishëm për sigurimin e një rrjedhe të vazhdueshme të punës dhe harmonizimin e sistemit për menaxhimin e dokumenteve për t'i përmbushur nevojat e Kuvendit, për sigurimin e qasjes, për përdoruesit, në dokumentet relevante me kohë, si dhe për krijimin e arkivave (dosjeve) elektronike që në të ardhmen të përdoren jo vetëm nga Kuvendi por edhe nga qytetarët. Së këndejmi, Kuvendi tani ka mundësi që ta përballojë ngarkesën në rritje të punës rreth legjislacionit të hartuar nga Qeveria e Kosovës në mënyrë efikase, të përgjegjshme dhe transparente.

Anëtarët e regjistruar qysh tani mund të kenë qasje në arkivat e Kuvendit përmes web-faqes së Kuvendit të Kosovës: <https://bscw.assembly-kosova.org/>

S'ka pikë dyshimi se sapo Kuvendi t'i miratojë rregulloret dhe procedurat e nevojshme edhe publiku i gjerë do të ketë mundësi që të kenë qasje në informatat e Kuvendit, nëpërmes qasjes në arkiva elektronike. Ndërkaq në një të ardhme më të largët, kjo tok me krijimin e Qendrës Informative të Qeverisjes Parlamentare, të vendosur në Bibliotekën Universitare, do të sigurojnë një qasje publike, transparencë dhe përgjegjësi më të madhe në punën e Kuvendit të Kosovës.



Kuvendi miratoi Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2006

Kim Vetting, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Për herë të parë gjatë dhjetorit të vitit të shkuar, Kuvendi mbajti disa diskutime serioze rreth buxhetit të vitit 2006 në seancat plenare, që zgjatën për dy ditë resht, para miratimit përfundimtar. Gjatë leximit të parë me 15 dhjetor buxheti u miratua në parim, ndërsa me 20 dhjetor pas leximit të dytë buxheti përfundimisht u miratua. Megjithatë, aprovimi u bë me disa vërejtje nga krerët e grupeve parlamentare të PDK-së dhe ORA-ës, të përfaqësuara me 28 vota, në opozitë, dhe me dy abstenimeve.

Vlen të vihet në dukje se gjatë dhjetë ditëve para leximit të parë, shumica e ministrave si dhe Agjencia e Kosovare e Mirëbesimit u ftuan në sesione të veçanta nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Fillimi i debatit në seancën plenare gjatë leximit të parë ishte mjaft i vështirë. Fillimisht, nuk pati përfaqësues nga Qeveria. Mirëpo, vetëm pas insistimit të krerëve të grupeve parlamentare të PDK-ës dhe LDK-ës, dhe pas kërkesës për pauzë të shefit të grupit parlamentar të AAK-ës, erdhën përfaqësuesit e qeverisë dhe debati vazhdoi në prezencën e disa anëtarëve të qeverisë dhe Kryeministrit.

Një nga çështjet më serioze të adresuara nga Kuvendi në leximin e parë ishte një e dhënë mjaft shqetësuese se më tepër se 60% e të hyrave të buxhetit vijnë nga doganat e jo nga ndonjë veprimtaria ekonomike siç është prodhimi. Kështu që nuk kishte shumë mundësi



që të merreshim me mjaft çështje dhe nevoja urgjente, siç janë përmirësimi i sistemit të shëndetësisë dhe arsimit. Së këtejmi, Kryetari i Komisionit i bëri thirrje Qeverisë që të gjejë mënyra për të stimuluar rritjen ekonomike.

Po kështu, me 20 dhjetor Kuvendi votoi për 25 amendamente, nga të cilat 23 ishin propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, një nga Komisioni i Kuvendit për Shërbime Publike dhe një nga grupi parlamentar i PDK-ës. Dy propozimet e fundit, për një rritje prej 10 %

në buxhetin e vitit 2006 për Sistemin Gjyqësor në Kosovë dhe propozimi i PDK-ës që linja buxhetore e Kryetarit të Kuvendit, të shndërrohet në linjë për Kryesinë e Kuvendit, u refuzuan, ndërsa të gjitha propozimet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa u miratuan me shumicë votash.

Sfida më e madhe për Komisionin e Buxhetit dhe Financave do të jetë përcjellja e shpenzimeve. Në vitin 2005, në disa raste, linjat buxhetore janë ndryshuar dhe madje edhe janë këmbyer midis buxheteve


të organizatave të ndryshme pa miratimin e Kuvendit. Së këtejmi, vendimi për rishikimin e buxhetit në mes të vitit, në qershor të vitit 2006, mund të jetë shumë i dobishëm për t'i tejkaluar problemet e ngjashme. Ngase, rishikimi i buxhetit është një rast i mirë për të diskutuar dhe për të rënë dakord rreth çështjeve apo ndryshimeve urgjente në buxhet.

Viti 2006 po ashtu i ofron mundësinë Komisionit për Buxhet dhe Financa që rre-gullisht dhe me kujdes t'i mbikëqyrë shpenzimet, duke filluar nga buxheti i Kuvendit. Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave, Zyra e Revizorit të Përgjithshëm dhe Thesarit, Komisioni duhet të jetë në gjendje që t'i identifikojë dhe definojë dobësitë në realizimin e buxhetit dhe të japë rekomandime për përmirësime të mëtejme. Në të njëjtën kohë të gjitha komisionet funksionale duhet t'i mbikëqyrin me kujdes buxhetet e departamenteve në kuadër të kompetencave të tyre. Përmirësimi i mbikëqyrjes së buxhetit nga ana e Kuvendit – ngase deputetët janë sytë dhe veshët e qytetarëve që i kanë zgjedhur- do të rezultojë padyshim në një shpenzim më koherent dhe efikas të mjeteve mjaft të limituara buxhetore.

BKK-ja për vitin 2006 është 700 million Euro krahasuar me buxhetin e vitit 2005 që ishte 737 million Euro. Ndërsa, për vitin 2007 buxheti i planifikuar është 705 milion Euro dhe për vitin 2008 është 708 milion Euro.

PROJEKTI I RI I AER-IT

“PËRKRAHJA E MËTEJME E KUVENDIT TË KOSOVËS “ FILLUAR ME 5 JANAR



Që nga themelimi i tij, Kuvendi i Kosovës është ndihmuar nga disa parlamente evropiane, qoftë përmes mbështetjes bilaterale apo edhe përmes iniciativave të OSBE-së. Kjo ndihmë dhe përkrahje është zyrtarizuar në vitin 2003 nga Agjencioni Evropian për Rindërtim kur filloi projekti për mbështetjen e Kuvendit, i cili iu besua koncernit të drejtuar nga Parlamenti Kombëtar Francez (French Assemblée Nationale) tok me Bundestagun Gjerman, Dhomenë e Përfaqësuesve të Belgjikës (Belgian Chambre des Représentants) dhe Institutin Ndërkombëtar të Parisit për Mbrojtje (Institut International de Paris La Defense (IIPLD)).

Ky projekt ka shënuar rezultate të mirëfillëta në fushat siç janë Rregullorja e Punës, hartimi i rregullores për stafin, rekomandimet për riorganizimin e Kryesisë dhe Sekretariatit, trajnimin e stafit lokal, asistencën teknike dhënë Departamentin për Çështje Ligjore mbi procesimin e legjislacionit dhe ndihmën profesionale për hartimin dhe shqyrtimin e ligjeve dhe harmonizimin e tyre me *Acquis communautaire*.¹

Marrë parasysh rezultatet pozitive dhe dëshirën për të forcuar lidhjet që tanimë janë krijuar, të tri parlamentet tok me Institutin Ndërkombëtar të Parisit për Mbrojtje (IIPLD) kanë vendosur që të aplikojnë sërish. Veç kësaj, ata kanë ftuar edhe Parlamentin e Sllovenisë që t'i bashkohet koncernit, dukembajtur parasysh

rezultatet mjaft mbresëlënëse që i ka arritur ky shtet-anëtarë i ri i UE-së gjatë tranzicionit demokratik, ndërtimit të institucioneve parlamentare, dhe harmonizimit me standardet evropiane. Oferta e tyre është pranuar dhe në dhjetor është nënshkruar kontrata.

Projekti i ri është ndarë në tri komponente, në:

- 1) Mbështetjen e mëtejme për procesin e ndërtimit të institucioneve
 - Fuqizimi i Sekretariatit të Kuvendit
 - Këshilla për Kryesinë e Kuvendit lidhur me zbatimin e Rregullores së Punës
 - Trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve
- 2) Asistencën teknike për Sekretariatit dhe Departamentin për Çështje Ligjore mbi shqyrtimin (procesimin) e legjislacionit
 - Mbështetja për hartimin e legjislacionit
 - Mbështetja për Njësinë për Çështje Ligjore dhe Standardizim dhe Harmonizimin e Legjislacionit.
- Përmirësimi i procesit legjislativ dhe koordinimi me Qeverinë dhe UNMIK-un.
- 3) Aktivitete që kanë për qëllim rritjen e bashkëveprimit midis Kuvendit dhe shoqërisë civile
 - Mbështetja për Sektorin për Media dhe Marrëdhënien me Publikun

- Përmirësimi i qasjes publike në Kuvend dhe dialogu me shoqërinë civile

Projekti do të drejtohet nga zonja Joëlle Affichard, drejtoreshë shkencore e Institutit Ndërkombëtar të Parisit për Mbrojtje (Institut International de Paris La Defense (IIPLD)), drejtoreshë e projektit. Ndërsa, ekipi përbëhet nga katër ekspertë kryesorë:

- Udhëheqës i ekipit, z. Jacques Roger-Machart, ish-nënkryetar i Parlamentit Kombëtar të Francës dhe ish këshilltar lokal i zgjedhur, me një përvojë të madhe në këto fusha: bashkëpunim ndërkombëtar, menaxhim publik, partneritet publik/privat, ndërveprim midis autoriteteve publike dhe shoqërisë civile, vlerësim të politikave publike dhe zhvillim rajonal.
- Eksperti i lartë ndërkombëtarë për çështje ligjore z. Alfons Lentze, një jurist holandez i specializuar në *Acquis communautaire*, hartim të legjislacionit dhe Rregullores të Punës, i cili edhe më parë ka punuar si ekspert i lartë për çështje ligjore në projektin e AER-it “Mbështetja për Zyrën e Kryeministrit të Kosovës”.
- Eksperti i lartë vendor për çështje ligjore z. Virtyt Ibrahimaga, jurist i specializuar në të Drejtën Evropiane dhe Ndërkombëtare, kornizën ligjore të Kosovës, hartimin e legjislacionit dhe Rregulloren

e Punës, harmonizimin me *Acquis communautaire*, i cili po ashtu ka qenë i angazhuar në projektin e kaluar me përgjegjësi të ngjashme.

- Ekspert për menaxhment/organizim z. Jean-Marie Lebaron, ish anëtar i stafit të nivelit të lartë të Senatit francez, i cili ka një përvojë të jashtëzakonshme në menaxhmentin e stafit parlamentar, marrëdhëniet midis Qeverisë dhe Parlamentit, vlerësimin e nevojave, përpilimin e programeve të trajnimit dhe trajnimin e stafit të parlamenteve të vendeve në tranzicion.

Pos këtyre, një rrjet me rëndësi i ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendorë do të kontribuojë rreth projektit. Të katër parlamentet do t'i shfrytëzojnë burimet e tyre dhe do të sigurojnë mjete optimale për implementimin e aktiviteteve të planifikuara.

Projekti ka filluar me 5 janar dhe do të zgjasë dy vite. S'do mend se gjatë fazës fillestare, që do të zgjasë gjashtë javë, do të instalohet zyria e projektit, identifikohen prioritetet e përfitueseve të këtij projekti, shqyrtohet plani i punës dhe do të themelohet Komisioni Drejtues.

Ndërsa, një ndër çështjet kryesore me të cilat do të merret ky projekt është edhe bashkërendimi me donatorët e tjerë që mbështesin Kuvendin, sidomos përmes ASI-it, me qëllim që të mos dublohen përpjekjet.

¹ Ndërmjet këtyre dy projekteve, OSBE-ja ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për Kuvendin përmes një projekti të përkohshëm të implementuar nga Institutin Ndërkombëtar i Parisit për Mbrojtje (IIPLD). Ky projekt është përqëndruar në këshillat ligjore për harmonizimin e legjislacionit me *Acquis communautaire*, mbështetjen e komisioneve dhe ofrimin e shërbimeve të përkthimit për nevojat e Kuvendit.

Iniciativat e NDI-së për vitin 2006



Chad Rogers

Thuhet se kur hynë ushtarët anglezë në këtë rajon gjatë Luftës së Parë Botërore, kreujt çka u është dashur për ta bërë të qartë përkatësinë kombëtare dhe qëllimet e tyre, është që ta zinin në gojë emrin e autores së mirënjohur dhe studiuses së shquar të Ballkanit Edit Durhamit. E njëjta gjë vlen edhe për Institution Nacional Demokratik (NDI), e gjithë çka u nevojitet atyre është që ta shqiptojnë mbiemrin e kryesueses së tyre 'Albright', për ta pasur të qartë se kush jemi dhe çfarë qëllimesh kemi.

Ky është viti i gjashtë i qëndrimit tonë në Kosovë, me mbështetjen e Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim të Shteteve të Bashkuara (USAID), dhe ne ishim krenarë që kryesuesja jonë me rastin e vizitës në Kosovë pati kënaqësinë që të njihet me përparimet e arritura në Kosovë brenda një kohe kaq të shkurtër. Fakti se kemi parti politike stabile dhe gjithëpërfshirëse, të cilat u votuan në mënyrë të lirë dhe të drejtë dhe që më pas u bënë pjesë e një Kuvendi mjaft të organizuar nuk janë arritje aq

të parëndësishme.

Megjithatë, mbetet mjaft punë për t'u bërë rreth përfaqësimit më të mirë të votuesve nga institucionet, integritit të minoriteteve dhe rritjes së transparencës. Duket se fjalët e Sekretares së Shtetit Albright më së miri e kanë përshkruar pjesën (fazën) tjetër të misionit tonë: "Ndërsa demokracia në planin afatgjatë është forma më stabile e demokracisë, në planin afatshkurtër ajo është forma më e brishtë."

Gjatë këtij viti, prioritet i NDI-së do të jetë ndihma dhe përkrahja e deputetëve, stafit dhe partive politike për ta ndërtuar një Kuvend, i cili do të jetë në gjendje t'i përfaqësojë interesat e qytetarëve, organizojë punën e tij dhe të sigurojë mbikëqyrje ekzekutive. Pos kësaj, ne do të vazhdojmë të punojmë drejtpërsëdrejti me partitë politike – jo vetëm ato shqiptare dhe serbe por edhe të komuniteteve të tjera që tanimë janë konsoliduar – për t'iu ardhur në ndihmë si për artikullimin e bindjeve dhe politikave të tyre përpara qytetarëve ashtu edhe për ta rritur dhe përmirësuar komunikimin midis anëtarëve.

Ndërkaq, në Kuvend ne do të punojmë me grupin kryesor të anëtarëve me qëllim që t'a fuqizojmë këtë institucion, ta bëjmë më përfaqësues dhe më të aftë për t'i përmbushur obligimet e tij. Me këtë rast, ne do t'u kushtojmë më tepër kohë dhe energji komisioneve, duke u ardhur në ndihmë anëtarëve të tyre për të mbledhur më tepër informata që e ndihmojnë vendim-marrjes dhe për të zbuluar mënyrat si për rritjen e nivelit të debatit ashtu edhe

të pjesëmarrjes publike. Dhe ç'është më e rëndësishmja, ne dëshirojmë të punojmë me Kuvendin për të parë se si e kryen funksionin e tij të mbikëqyrjes ekzekutive, për të siguruar jo vetëm një legjislacion të mirë por edhe zbatimin e tij.

Me partitë politike, përmes asistencës profesionale dhe trajnimeve, do të punojmë rreth shtimit të sasisë së informatave që qarkullojnë brenda partive dhe kapacitetit të tyre për të komunikuar ide; ide, që mund të vijnë në formë të bindjeve partiake, politikave të veçanta dhe propozimeve në Kuvend.

Kam pasur rastin që të kthehem në Kosovë për disa herë, qysh nga koha kur fillova të punoj këtu për herë të parë në vitin 2003, ndaj për mua është një privilegj dhe kënaqësi e veçantë që shoh aq shumë përparime dhe që të kemi rastin të punoj sërish me partnerët, që janë të përkushtuar ndaj të ardhmes po aq sa edhe ndaj të kaluarës së tyre. Pa dyshim se edhe ne duhet të shënojmë përparime, duke ofruar më shumë trajnime të avansuara, ekspertizë më të nduarshme, dhe programe më të veçanta. Me një fjalë, ne po e ndryshojmë rolin tonë, duke u bërë më pak "mësues" dhe gjithnjë e më tepër këshilltarë.

Së këndejmi, ne vetëm po e luajmë rolin e katalizatorit. Pra, ne do ta shfrytëzojmë përvojën tonë globale në më tepër se 80 vende, rritjet tonë të ekspertëve politikë dhe ligjorë dhe ekipin tonë vendor për t'u ofruar ndihmë politikanëve, liderëve dhe aktivistëve në mënyrë që ata

të jenë në gjendje t'u shërbejnë më mirë interesave publike.

Për këtë arsye, tevona ekipit tonë i është bashkuar edhe David Payne (dpayne@ndi.org), i cili do të shërbejë si ekspert i programeve tona për fuqizimin e legjislacionit. David-i ka më shumë se 15 vjet përvojë si anëtar i zgjedhur, duke punuar jashtë vendit në sektorin e zhvillimit dhe si diplomat me përvojë, e cila e ka bërë atë plotësisht të kualifikuar që t'u ndihmojë dhe shërbejë si deputetëve ashtu edhe stafit të Kuvendit.

Është e udhës të vihet në dukje se Zyra jonë ka bërë një rioorganizim të brendshëm me qëllim që jo vetëm t'u shërbejë më mirë partnerëve tanë por edhe t'i reflektojë më mirë fushat e veprimtarisë sonë. Kësisoj, Edmond Efen-dija (eefendija@ndikv.org) do ta kryesojë Programin për Fuqizim Legjislativ, Arta Zherka (artazherka@ndikv.org) do ta udhëheqë Programin e Partive Politike, ndërkaq Zoran Blagojevic (zoran@ndikv.org) do ta marrë përsipër detyrën e re për ta drejtuar punën tonë me minoritete. Ndaj, nëse ka ndonjë fushë ku programi ynë do të mund të plotësonte ndonjë iniciativë në të cilën ju apo organizata e juaj është duke punuar apo edhe nëse dëshironi të merrni më tepër informata rreth veçorive të punës sonë, ju lutem kontaktoni udhëheqësit e programeve tona.

Chad Rogers (crogers@ndi.org) është drejtor i programeve të Institutit Nacional Demokratik në Kosovë. Për më tepër informat ju lutem, vizitoni web-faqen e NDI-së www.ndi.org

OSBE-ja ofron këshilla për Kuvendin e Kosovës

Peter Vanhoutte, Këshilltar Special i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës

Ende më kujtohet kur Kuvendi filloi për herë të parë punën para dy vitesh. Anëtarët e Kuvendit (AK) nuk dinin se çfarë pritej nga, ndaj u dukej sikur ndodheshin në një anije pa timonier. Sot, Kuvendi është duke funksionuar dhe duke u zhvilluar si një institucion i mirëfilltë demokratik. AK-ët tanimë janë bërë politikanë të mirëfilltë, madje shumë prej të cilëve do të mund të punonin në çdo Parlament në BE.

Viti 2006 është vit crucial për Kosovën. Dhe Kuvendi do të përballet me shumë sfida. Së këtejmi, për të përmirësuar funksionimi i tij, Kryetari ka propozuar një plan veprimi mjaft gjithëpërfshirës. Rifillimi i seancave plenare javore ku do të ketë kohë të mjaftueshme për t'i parashtruar pyetje Qeverisë, pa dyshim se do të jetë një ndër aspektet më të dukshme të këtij plani. Riorganizimi i stafit, do të jetë më pak i dukshëm, por shumë më i rëndësishëm në mbështetjen e AK-ve.

Vitin e shkuar, Kuvendi ishte i përkushtuar dhe i angazhuar rreth mbështetjes së negociatave. Ndërsa, këtë vit sfida më e madhe për Kuvendin është drejtimi i proceseve në tërë shoqërinë kosovare, jo vetëm për çështjet siç është statusi i ardhshëm, por edhe për zgjidhjen e problemeve të përditshme. Kështu në radhë të parë ka nevojë urgjente për legjislacion dhe rregullore shtesë për arsim, kujdes shëndetësor, zhvillim ekonomik por edhe për zbatimin e legjislacionit ekzistues. Njëherit, Kuvendi

duhet të ndër marrë hapa të mëtejme rreth hartimit të planeve të veprimit për rininë, luftimin e papunësisë si dhe për përgatitjen e planeve me veprime konkrete për përmirësimin e arsimit, kujdesin shëndetësorë dhe mjedisin. Së këtejmi, Kuvendi duhet ta ketë rolin kryesor sa i takon mbështetjes dhe shtyerjes përpara të këtyre proceseve, të cilat janë prioritete për vitet e ardhshme.

Si këshilltar special i Kryetarit të Kuvendit, kohëve të fundit kam mësuar që- sikundër edhe në çdo parlament europian, kryetari i Kuvendit mban një përgjegjësi të madhe për zhvillimet politike në vend. Prof. Daci është thellësisht i angazhuar për të ardhmen politike të Kosovës, plotësisht i vetëdijshëm që ai është Kryetar i Kuvendit dhe që flet jo vetëm në emër të një partije, jo vetëm në emër të shumicës, por në emër të të gjithë përfaqësuesve të zgjedhur. Mirëpo, për t'u reflektuar më mirë kjo në funksionimin e Kuvendit, lipset të themelohen mekanizma plotësues që do ta forconin gjendjen dhe pozitën e Kuvendit. Mekanizmat e tillë, si mbajtja e mbledhjeve të rregullta të shumicës, tok me qeverinë dhe opozitën, udhëzimet e qarta për ministrat dhe pjesëmarrja e tyre nëpër mbledhje si të komisioneve ashtu edhe në ato plenare janë vitale për funksionimin demokratik të të gjitha institucioneve.

Po ashtu kam mësuar që në kuadër të Kryesisë së Kuvendit,

ka një shqetësim serioz lidhur me respektimin e Rregullorës së Punës dhe me rritjen e mundësisë për diskutime të hapura. Megjithatë, ende mungon komunikimi i brendshëm ndërmjet krerëve të grupeve parlamentare, parlamentarëve, udhëheqësve të grupeve parlamentare, anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit, partive përkatëse të tyre dhe grupeve parlamentare. Në praktikën parlamentare, komunikimi në të gjitha nivelet është jashtëzakonisht me rëndësi. Marrja me çështjet dhe marrëveshjet e arritura gjatë mbledhjeve të komisionit apo seancave plenare nuk është një gjë e mirë, përpos nëse paraprakisht joformalisht është rënë dakord mbi çështjen në fjalë. Prandaj, është në interes të Kuvendit, që t'i përmirësojë kontaktet dhe diskutimet e tilla joformale që bazohen në besim reciprok.

Po kështu, edhe muaji i ardhshëm do të jetë vendimtar për Kuvendin, nëse shikohet nga një perspektivë tjetër. Dhjetorin e shkuar, Qeveria përuroi ndërtesën e re. Ndaj dhe Zyrja e Kryeministrit është duke u riakomoduar, çka do të thotë se do të ketë hapësira dhe zyre shtesë për Kuvendin. Ndërtesa e Kuvendit tani vërtetë do t'i përkasë Kuvendit, ndaj kjo do të bëjë të mundur që të mbahen më shumë mbledhje të komisioneve apo mbledhje të krerëve të grupeve parlamentare. Shpresojmë, që grupet e vogla parlamentare do të mund të zhvendosen në zyre të lira dhe që AK-



Peter Vanhoutte

ët përfundimisht të kenë hapësirë të mjaftueshme. Së këndejmi, kjo do të duhej të inkurajonte Kuvendin për avancimin e aktiviteteve legislative në fushën e zhvillimit të Kushtetutës dhe rregulloreve plotësuese si dhe në mbështetjen, themelimin dhe funksionimin e ministrive të reja, asaj për Punë të Brendshme dhe të Drejtësisë.

Zhvillimi i marrëdhënieve efikase rajonale dhe ndërkombëtare do të jenë prioritetet e agjendës për këtë vit. Mbetem me shpresë se Komisioni i Kuvendit për Marrëdhënie Ndërkombëtare do të bëjë përpjekje serioze për avancimin e këtyre marrëdhënieve, ngase Kosova në të ardhmën nuk duhet të mbetet një ishull i izoluar në Ballkan, por të integrohet plotësisht në BE dhe në strukturat Euro-Atlantike.

Vizioni dhe plani për të ardhmen

Në pranverën e vitit 2005 OSBE-ja me kërkesën e Komisionit të Kuvendit për Arsim ka inicuar projektin “Konsulenca e Ekspertëve për Komisionin e Kuvendit për Arsim”. Ky projekt parasheh që një ekspert me përvojë të punojë për Komisionin për Arsim për katër muaj. Prandaj, që nga 15 qershori në Prishtinë ka filluar punën si këshilltarë z. Reijo Aholainen, këshilltarë për arsim në Ministrinë e Arsimit e Finlandës.

Misioni kryesor i z. Reijo Aholainen është që t’i vijë në ndihmë Komisionit për të hartuar një strategji afatgjate të arsimit, tok me Ministrinë e Arsimit dhe palët e tjera të interesuara. Së këtejmi, pritet që z. Aholainen ta këshillojë Komisionin e Arsimit mbi shqyrtimin e projektligjeve për arsimin, ta mbikëqyrë implementimin e legjislacionit, ta përmirësojë funksionimin e Komisionit të Arsimit dhe ta shtojë përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit ndaj Komisionit. Ky projekt do të vazhdojë deri në fund të muajit tetor 2005.

Fillimisht, projekti është përqëndruar në hartimin e strategjisë dhe në këshillimin e Komisionit lidhur me projektligjet. Dr. Enver Hoxhaj, kryetari i Komisionit për Arsim konsideron se detyra më e rëndësishme e konsulencës

është përgatitja e një propozimi për një strategji të plotë dhe të integruar afatgjate për gjithë sektorin e arsimit dhe aftësimin profesional. Gjatë kësaj vjeshte pritet që z. Aholainen t’i vijë në ndihmë Komisionit që të organizojë debate dhe konsultime me akterët e tjerë përkitazi me hartimin e strategjisë. Pasi të hartohet strategjia, ky projekt parashikon që t’i ftojë të gjithë politikbërësit dhe palët e tjera të interesuara për të debatuar lidhur me propozimet. Ndërkaq, më vonë do të publikohet strategjia e plotë dhe do t’u shpërndahet të gjitha palëve të interesuara.

Përse ekziston nevoja për një strategji të arsimit në Kosovë?

Është më se e qartë se ekziston nevoja për një strategji të plotë dhe të integruar afatgjate që do të mbulonte gjithë sferën e arsimit dhe aftësimin profesional, si dhe për prioritizimin e nevojave, me qëllim që të bëhet i mundur implementimi i saj me burimet aktuale në dispozicion. Njëherit, vlen të vihet në dukje se strategjia duhet të ndërlihet me strategjinë për zhvillimin ekonomik të Kosovës si dhe me zhvillimet dhe perspektivat e integritit evropian. Së këtjemi, strategjia e arsimit duhet të

përqëndrohet në mbështetjen e rritjes ekonomike dhe të punësimin. Është e qartë se e vetnja mundësi për ta shtuar numrin e të punësuarve dhe mirëqenien në Kosovë është përmes rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Ndërkaq, punësimi dhe rritja ekonomike pastaj hapin shtegun për shtimin e fondeve publike për arsim dhe aftësim profesional. Nga ana tjetër, tanimë dihet se zhvillimet evropiane, e në veçanti ato në UE, përcaktojnë kornizën e të ardhmes së Kosovës.

‘Vizioni dhe plani për të ardhmen’

Gjerë më tani, në kuadër të këtij projekti ia kemi dalur mbanë të hartojmë një Konspekt (Sinopsis) për një Strategji shumëvjeçare të arsimit në Kosovë me titull: “Vizioni dhe plani për të ardhmen” (që njëherësh është përkthyer edhe në gjuhën shqipe dhe serbe). Ky Konspekt është mbështetur jo vetëm në dokumentet relevante mbi arsimin dhe situatën aktuale në të cilën ka hasur këshilltari por edhe në mbledhjet dhe diskutimet e dendura me anëtarët e Komisionit për Arsim, me shërbyes të lartë civil të MASHT-it dhe MPMS-së (MLSW) dhe me ekspertët ndërkombëtarë.

Sipas Konspektit vetëm një nu-

mër i vogël i prioriteteve të zhvillimit (3 - 5) janë të përcaktuara për gjithë sistemin e arsimit deri në vitin 2015. Më konkretisht, draft Konspekti (Sinopsis) i përcakton katër çështje si dhe prioritetet e mundshme për të ardhmen:

- 1) Mbështetja e zhvillimit dhe rritjes ekonomike në Kosovë. Çështja kryesore është që të mbështetet zhvillimi ekonomik kombëtar përmes ngritjes së cilësisë dhe lidhjes së tregut të punës me aftësimin profesional dhe arsimin e lartë në sektorët ekonomik në të cilët ka gjasa të mira për të shënuar rritje në të ardhmen.
- 2) Sigurimi i arsimit elementar për të gjithë, përfshirë minoritetet. Këtu, çështja më urgjente është reduktimi i shkallës së nxënësve që e braktisin shkollimin në arsimin fillor dhe të mesëm, duke i kushtuar kujdes të veçantë me këtë rast grupeve të ndjeshme (apo të cënueshme) si minoritetet dhe fëmijët me nevoja të veçanta.
- 3) Shtimi i mundësive për arsim të përjetshëm. Sfidë më e madhe është përmirësimi i mundësive dhe shanseve për të mësuar për dhjetëra mijëra të rinjë, që nuk kanë shkathësi, njohuri dhe aftësi për të punuar për shkak të kushteve dhe gjendjes tejte të rëndë gjatë viteve të 90-ta dhe në periudhën pas konfliktit.
- 4) Përmirësimi i cilësisë në arsimin e lartë dhe puna hulumtuuese në universitet. Kualiteti i studimeve në arsimin e lartë ka të bëjë me kompetencën, aftësinë dhe

Komisioni i Kuvendit për Arsim inicon një strategji afatgjate për arsim

Tanimë situata dhe problemet me të cilat po ndeshet arsimin në Kosovë janë përshkruar në një sërë dokumentesh, të hartuara si nga organizatat ndërkombëtare ashtu edhe nga IPVQ-ët. Fjala vjen, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka hartuar strategjitë për arsimin fillor dhe të mesëm, arsimin e lartë, arsimin dhe aftësimin profesional, arsimin për të rritur dhe arsimin në zonat rurale. Megjithatë, Kosovës ende i mungon një strategji e plotë, e integruar dhe afatgjate, ku do të përfshihej i gjithë sistemi i arsimit dhe aftësimin profesional dhe ku do të radhiteshin nevojat për përmirësim sipas prioriteteve në mënyrë që ato të vihen në jetë edhe me këto burime të limituara. Së këtejmi, tani Komisioni i Kuvendit për Arsim është duke e shqyrtuar këtë çështje dhe ka inicuar hartimin e një strategjie të këtillë.

kapacitetin e mësuesve dhe profesorëve. Ndonëse puna kërkimore ka mundësi shumë të madhe për ta ngritur cilësinë e arsimit të lartë, ajo për një kohë të gjatë është lënë pas dore.

Me të rënë dakord Komisioni për Arsim i Kuvendit, tok me MASHT-in, Vizioni do të kurorëzohet me një Plan, i cili i identifikon hapat e domosdoshëm për t'i sëndërtuar objektivat e strategjisë, siç janë rendi logjik i reformave, afati kohor dhe financimi. Ndërkaq, vënja në jetë e këtij Plani duhet të mbështetet nga plane më të detajuara të Veprimit të Qeverisë, për të cilat mund të kërkohet bashkëfinancim nga donatorët. Njëherit, strategjia duhet të mbështetet me një fushtë të promovimit publik në media.

Impenjimi i palëve të interesuara është çështja më e rëndësishme

A strategy is made to guide the right education measures and their resources in Kosovo for years to come. Therefore a true commitment of all main stakeholders is the most important precondition in designing the strategy. There should be a true consensus about the priorities and the implementation measures. The stakeholders' contribution shall become crucial in the implementation phase. Most likely the strategy's completion needs more time than is provided for the project. Therefore it is necessary to prepare one or more follow-up projects for the technical assistance needed after October 2005.

Reijo Aholainen, Ekspert në Ministrinë e Arsimit të Finlandës dhe këshilltarë i Komisionit të Kuvendit për Arsim.

Puna e Kuvendit nga një këndvështrim tjetër

Një projekt i llojit të veçantë, i filluar në pranverën e vitit të kaluar, filloi të realizohet në Kuvendin e Kosovës nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, ku për qëllim ishte praktika institucionale për gjashtë muaj që do ta ndiqnin studentët të Universitetit të Prishtinës, në secilin Grup Parlamentar që zhvillon veprimtarinë në Kuvend.

Projekti kishte për qëllim punësimin të përkohshëm të studentëve, kryesisht nga lëmi i drejtësisë, shkencave politike, por edhe të drejtimeve tjera. Studentët praktikant do të asistonin me angazhimin e tyre në punën e përditshme të Grupit Parlamentar, gjegjësisht në përgatitjen e materialeve për deputet në seanca plenare të kuvendit, përpilimin e komunikatave, organizimin dhe përcjelljen e takimeve dhe skedimin e dokumenteve brenda zyrës.

Kishim fatin që së bashku me koleg tjerë të ishim pjesë e këtij programi shumë tërheqës dhe dobiprurës. Duke qenë në përfundim të studimeve, puna gjashtë mujore që kemi zhvilluar ka qenë njëra ndër eksperiencat më të mira të fituara në kohët e fundit. Eksperienca jonë, përmbledhet në tri forma.

E para, për një kohë të shkurtër arritëm të njihemi me legjislacionin e Kosovës, duke takuar nga afër deputetët dhe njëkohësisht duke bashkëpunuar me një numër të madh prej tyre. Në masë të madhe kemi ndjekur të gjitha seancat e zhvilluara parlamentare duke shikuar nga afër debatin

politik që zhvillohej për tema të ndryshme. Gjithashtu kishim kënaqësinë të asistonim në Grupin Parlamentar të ORA-së ku shefe e Grupit është Teuta Sahatqija e cila na ofroi gjithë bashkëpunimin dhe lehtësoi punën tonë.

E dyta, një pjesë të njohurive teorike të marra në universitet arritëm ti aplikonim në punën e përditshme, si në analizimin e ligjeve, përcjelljen e vazhdueshme të shtypit kosovar dhe atij të huaj, ndjekjen e seancave të dëgjimit publik nëpër komisionet e përhershme parlamentare.

E treta, gjatë zhvillimit të praktikës, së bashku me koleg të tjerë kemi ndjek një numër të konsiderueshëm trajnimesh, me qëllim të përshtatjes sa më të madhe me punën, për të qenë kështu efikas. Trajnimet e ofruara nga OSBE dhe Kuvendi, kanë shërbyer në masë të konsiderueshme në avancimin e përgatitjes tonë profesionale.

Përfundimisht, projekti i filluar nga OSBE-ja në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës dhe grupet parlamentare, mund të

konsiderohet projekt mjaftë i rëndësishëm. Për faktin, që arrin të ofroj praktik institucionale për studentët e Universitetit të Prishtinës, forcon punën e grupeve parlamentare, veçmas deputetëve gjatë angazhimit të tyre politik dhe profesional dhe mundëson aftësimin për pune praktike. Vlen të theksohet se një pjesë e praktikantëve kanë marr përvojë të rëndësishme dhe tashmë kanë siguruar punë afatgjate. Po ashtu, grupi i dytë i studentëve trashmë veç ka filluar me punën e tyre, gjegjësisht me fazën e radhës së projektit. Rast i mirë, për tu ndjekur si shembull edhe nga institucionet tjera qeveritare qendrore dhe ndër-kombëtare në Kosovë që të ndërmarrin projekte të ngjashme. Kishim kënaqësinë dhe fatin të ishim pjesë e këtij projekti duke bashkëpunuar me njerëz profesionist dhe për të kontribuar sadopak, për Grupin Parlamentar ORA.

Përgëzimet tona për njerëzit që e iniciuan dhe ndihmuan këtë projekt.

Bashmir Xhemaj e Samir Reka



Kontrolli parlamentar i sektorit të sigurisë

Teodora Fuior, Këshilltar i Komisionit për Mbrojtje, Rend Publik dhe Siguri Kombëtare në Dhomën e Deputetëve, Parlamenti Rumun.

Në shumë vende të botës njerëzit shpeshherë sigurinë dhe demokracinë i shohin si dy gjëra të papajtueshme. Kjo ndodh në radhë të parë për arsye se shteti demokratik duhet të bëjë të mundur ushtrimin e lirë të të drejtave dhe lirive të qytetarëve. Ndërsa, nga ana tjetër, për të garantuar sigurinë e qytetarëve të vet, shteti duhet të ketë institucione të fuqishme dhe një sektor efikas të sigurisë, i cili në raste të jashtëzakonshme mund t'i kufizojë këto të liri dhe të drejta.

Një nga detyrat dhe misionet më të rëndësishme të Parlamentit është që të bëjë të mundur që siguria dhe demokracia të jenë të pajtueshme me njëra tjetrën. Parlamenti është mbrojtësi më i mirë i demokracisë meqë zgjidhet nga populli dhe e përfaqëson vullnetin e popullit.

Së këndejmi, përmes ushtrimit të funksioneve themelore të tyre, parlamentet janë të involvuar në procesin e definimit, formulimit dhe zbatimit të politikave të sigurisë.

S'ka pikë dyshimi se funksioni i parë i Kuvendit është që t'i përfaqësojë qytetarët. Pikërisht për këtë arsye, ky institucioni ka përparësi ndaj insitucioneve të tjera shtetërore, dhe madje është edhe mbikëqyrës i ekzekutivit. Nga të gjitha institucionet qeverisëse, parlamentet janë më të hapurat ndaj opinionit. Ato i reflektojnë jo vetëm mendimet dhe opinioniet e qytetarëve por edhe diversitetin e shoqësisë. Kjo do të thotë se parlamentet reflektojnë në të njejtën kohë edhe mosmarrëveshjet dhe konfliktet në shoqëri, duke shërbyer kështu si arenë publike për debate politike dhe negociata që kanë për qëllim ndërtimin e konsensusit

në shoqëri.

Funksioni proaktiv i Kuvendit, duhet të jetë i orientuar kah politikat dhe aktivitetet e ardhëshme të ekzekutivit me qëllim të krijimit të kornizës ligjore kombëtare. Ngase përmes ligjeve parlamentet i krijojnë institucionet e shtetit dhe i përcaktojnë autorizimet e tyre.

Ushtrimi i funksionit të mbikëqyrjes parlamentare është instrument reaktiv që përdoret nga Kuvendi për të vlerësuar aktivitetet dhe politikat të cilat tanimë janë implementuar. Në vendet demokratike, përfaqësuesit e popullit e mbajnë pushtetin suprem, ndaj asnjë sektor i shtetit nuk duhet të jetë jashtë kontrollit të tyre.

Megjithatë, natyra e sektorit të sigurisë paraqet një mori sfida për realizimin e një kontrolli të mirëfillët dhe efikas.

Të fillojmë me kompleksitetin. Parlamentarët duhet të shqyrtojnë dhe mbikëqyrin institucione dhe çështje të ndryshme si forcat e armatosura, policia dhe forcat e tjera për ruajtjen e rendit publik, kontrollimin e kufirit, sigurimin e buxhetit, prokurimin, kontrollimin e armëve, aktivitetet e agjencive të zbulimit, etj. Për më tepër, çështjet e sigurisë moderne kanë edhe një dimension të rëndësishëm transnacional.

S'do mend se sektori i sigurisë është më pak transparent se sa aktivitetet e tjera, jo vetëm për shkak të nevojës për ruajtjen e informatave të rëndësishme për sigurinë kombëtare, por edhe për shkak të natyrës dhe mentalitetit ushtarak. Në shumë vende, institucionet që kanë monopol ligjor ndaj forcës zhvillohen si shtete brenda shteteve që do të thotë, i kanë vlerat, normat, disiplinën, shk-

ollat, gjyqet, spitalet e veta, etj.

Inercionit të madh burokratik të sektorit të sigurisë mund po ashtu t'i shtohet edhe involvimi i fuqishëm i ekzekutivit, i cili është i prirë që t'i shohë politikat dhe institucionet e sigurisë si përgjegjësi të sajën, dhe si një fushë ku ekziston një involvim i dobët i shoqësisë civile, i cili është pak i informuar apo edhe i paineduar për çështjet e sigurisë.

Si mund t'i tejkalojnë deputetët këto sfida dhe të ofrojnë mbikëqyrje efikase të sektorit të sigurisë? Ekzistojnë tri nivele të veprimit, secili prej tyre e domosdoshme dhe me ndikim në sektorin e sigurisë, por që janë shfrytëzuar në mënyra të ndryshme varësisht prej Parlamentit. Ato nivele janë: sesionet plenare, komisionet, dhe veprimet individuale të ndërmarra nga deputetët e Kuvendit.

1. Sesionet plenare

Parlamentet debatojnë në seancat e tyre plenare mbi dokumentet dhe vendimet që e rregullojnë sistemin e sigurisë kombëtare si: Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Letra e Bardhë e Qeverisë për Siguri dhe Mbrojtje apo edhe dokumente të tjera afatgjata. Në seancat plenare ekzekutivit mund t'i jipet besimi rreth një politike apo legjislacioni të veçantë në fushën e sigurisë apo edhe t'i revokohet ky besim përmes mocionit të kundërshtimit (cenzurës).

Parlamentet, në seancat e tyre plenare miratojnë legjislacionin, i cili e përcakton dhe e rregullon madhësinë, strukturën, organizimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore që kanë mandat për përdorimin e forcës; si dhe të organeve civile

të menaxhimit, të cilat i përgatisin dhe marrin vendime rreth përdorimit të forcës.

Një nga ligjet më të rëndësishme të miratuara nga Kuvendi është Ligji mbi Buxhetin. Fuqia e qeses/ financave është një mjet parlamentar shumë efikas, i cili siguron kontrollin e forcave të sigurisë. Ngase i bënë të mundur Kuvendit që të jetë i informuar për atë se ku shkojnë paratë, rrit transparencën për shpenzimet publike dhe përgjegjësinë e zyrtarëve qeveritarë.

Parlamentet në seancat plenare japin pëlqimin për emërimet të larta në sektorin e sigurisë, si fjala vjen të ministrave, drejtorëve të agjencisë së zbulimit dhe të agjencive të tjera. Njëherësh ata janë kompetentë për të miratuar numrin maksimal të personelit të punësuar në ministri dhe forca të sigurisë.

Parlamentet sipas ligjit kanë një rol vendimtar në përcaktimin të gjendjes së jashtëzakonshme dhe të gjendjes së luftës, si dhe në shpalljen dhe shfuqizimin e gjendjeve dhe masave të këtylla. Njëherazi, në seancat plenare Parlamentet i ratifikojnë marrëveshjet ndërkombëtare.

2. Komisionet janë krijuar me qëllim që të ndahet puna e Parlamentit midis grupeve të specializuara të parlamentarëve, të cilët pastaj japin këshilla në seancat plenare. Struktura permanente e komisioneve të Kuvendit është e ngjashme me strukturën e Qeverisë. Së këndejmi, në shumicën e parlamenteve ekziston një komision permanent i specializuar për secilën ministri. Zakonisht, komisionet e involvuara në sektorin e sigurisë në baza ditore janë ato që meren me forcat e

armatosura, rendin publik, dhe shërbimin e zbulimit. Ndërkaq, komisionet mandatet e të cilave janë më pak të lidhura me sektorin e sigurisë janë ato që meren me punët e jashtme, buxhet, energji dhe industri dhe shkencë dhe teknologji.

Përparësia e punës në komisione, përpos koncentrimit të ekspertizës në një vend, është edhe mungesa e publicitetit dhe mbulimit mediatic, i cili inkurajon dialog të hapur, lehtëson negociatat dhe krijimin e pikëpamjeve dhe qëndrimeve të përbashkëta.

Të gjitha vendimet dhe ligjet që miratohen në seancën plenare së pari përgatiten dhe diskutohen detajisht në komisione. Puna në komisione, kur zhvillohen negociata ndër-partiake si dhe midis qeverisë dhe parlamentit, shpeshherë rezulton në ndryshime të mirëfillëta në draft legjislationin e Qeverisë. Raportet dhe rekomandimet e tyre gëzojnë mbështetje të përgjithëshme, ndaj dhe në seancën plenare ato zakonisht përkrahen.

Komisionet, pavarësisht nga senacat plenare dhe më të lirë në punë dhe orar, ushtrojnë mbikëqyrje të gjërë të kompetencave për të hetuar çështjet kryesore të politikave publike, mangësitë në administratë, dhe akuzat për korrupsion apo skandal. Veprimet konkrete që ndërmirren nga një komision për të kontrolluar ekzekutivin përfshijnë mbajtjen e dëgji-

meve publike dhe hetimore; thirrjen e personelit ushtarak, shërbyesve civil apo ekspertëve për të dëshmuar në mbledhjet e komisioneve; marjen në pyetje të ministrave dhe përfaqësuesve të tjerë të ekzekutivit; kërkimin e dokumenteve nga ekzekutivi- shqyrtimin e peticioneve dhe ankesave të personelit ushtarak dhe civil; dhe organizimin e vizitave dhe inspektimeve të bazave ushtarake dhe objekteve të tjera të sektorit të sigurisë.

3. Përpos aktiviteteve të tyre në seanca plenare dhe në komisione, parlamentarët mund të ndërmarrin edhe nisma individuale për mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Në shumicën e vendeve, deputetët e Parlamentit kanë të drejtë të inicojnë dhe të amendojnë ligje. Ata po ashtu kanë të drejtë t'i adresojnë edhe pyetje dhe interpele nca ekzekutivit, i cili e ka për detyrë të përgjigjet. Mirëpo, për t'i përdorur më mirë këto të drejta, deputetëve të Parlamentit u nevojitet dije dhe informacion.

Dy burimet kryesore të informacionit janë ekzekutivi dhe zgjedhësit e tyre. E drejta për të kërkuar informata nga ekzekutivi shfrytëzohet shpesh nga parlamentarët. Ndërsa, elektorati si një burim i vlefshëm i informatave shpeshherë shpërfillet, ndaj parlamentarët duhet të bëjnë më tepër për të pasur kontakte më të shpeshta me zgjedhësit e tyre.



komuniteteve që të jetojnë dhe prosperojnë të sigurtë. Ministrat po ashtu i bëjnë thirrje serbëve të Kosovës dhe minoriteteve tjera ta shfrytëzojnë mundësinë, që përmes procesit të statusit të sigurojnë adresimin e plotë të çështjeve të tyre.

Parimet Udhëzuese të Grupit të Kontaktit të nëntorit 2005, kanë bërë të qartë se: nuk do të ketë kthim të gjendjes para vitit 1999, nuk do të ketë ndarje të Kosovës dhe nuk do të ketë bashkim të Kosovës me ndonjë shtet tjetër apo pjesë të ndonjë shteti. Ministrat në të njëjtën kohë ritheksojnë vullnetin e komunitetit ndërkombëtar për të krijuar struktura të mjaftueshme ndërkombëtare civile dhe ushtarake, që do të qëndronin për një periudhë të përkohshme pas zgjidhjes dhe që do të përkujdeseshin për respektimin e marrëveshjes. Qeverisja, që duhet të bëhet në baza multi etnike dhe duhet të mbështet përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës. Ministrat i bëjnë thirrje NATO-s që të vazhdojë përkushtimin e vet për të krijuar dhe ruajtur një ambient të sigurite përmes KFOR-it.

Ministrat kërkojnë nga Beogradi, që ta ketë parasysh se zgjidhja e nevojshme, ndër të tjera duhet të jetë e pranueshme për popullin e Kosovës. Kjo për faktin se pikërisht politikat shkatërrimtare të së kaluarës i kanë shkaktuar problemet. Sot, udhëheqësit e Beogradit mbajnë përgjegjësi të madhe për atë se çfarë do të ndodh tani dhe në të ardhmen. Së këndejmi, Grupi i Kontaktit, BE-ja dhe NATO-ja janë të gatshëm t'i mbështesin forcat demokratike serbe, në shfrytëzimin e kësaj mundësie të çuarjes përpara të

Serbisë. Ministrat mirëpresin arrestimin e Jovo Djogo-s, por ritheksojnë se udhëheqësia duhet t'i plotësoj zotimet e tyre të përsëritura për bashkëpunimin e plotë me Gjykatën Ndërkombëtare për Krime të Luftës, veçanërisht për sa i përket Mladic-it dhe Karadzic-it. Ministrat e këshillojnë në masë të njëjtë Prishtinën që të pranojë dhe të pajtohet se zgjidhja multi-etnike është opcioni i vetëm i realizueshëm, ndaj dhe sa më shumë të adresohen interesat vitale të minoriteteve aq më shpejtë mund të arrihet një zgjidhje e pranueshme për të gjithë. Ministrat ua tërheqin vërejtjen atyre që tentojnë ta përdorin forcën se në këtë mënyrë ata vetëm sa do ta dëmtojnë çështjen e tyre.

Së fundi, ministrat vurën në pah se zgjidhja e arritur përmes bisedimeve është mënyra më e mirë që të ecet përpara. Kjo për faktin se një zgjidhje e tillë do të ndihmojë në krijimin e rrethanave në të cilat zgjidhja do të funksionojë dhe do të jetë në të mirën e të gjithëve. Njëherit, edhe angazhimi konstruktiv i partive do ta trasojë rrugën për një të ardhme në Evropë dhe strukturat Euro-Atlantike. Ministrat i inkurajojnë udhëheqësit në Serbi dhe Kosovë të tregojnë pjekuri politike dhe vizion të mirëfilltë, të dalin me propozime reale dhe largpamëse, që do të bëjnë të mundur krijimin e një ardhmërie më të mirë si të Kosovën ashtu edhe të Serbinë. Ata kanë kërkuar nga i Dërguari Special për Status dhe PSSP-ja, që t'i njoftojnë rregullisht rreth zhvillimeve dhe progresit të arritur dhe që t'i përgjigjen kërkesave të tyre apo edhe nëse një gjë të tillë e kërkon situata.



Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respektimin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgjegjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legjislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevojat në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinator i ASI-t Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregulltë i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombëtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparsamentar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Sven Lindholm, Ramush Tahiri, Franklin De Vrieze, Blerim Vela, Labinot Hoxha, Edmond Efendija, Krenar Loshi.

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
http: / / www.osce.org/ kosovo

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini :

OSBE: fq. 2,12,19,21/

Gazeta e përditshme Express: fq. 1, 2 (Fisnik.Dobreci) fq. 3 (Andrew Testa) fq. 5, 23 (Astrit Ibrahim) fq. 8 (Ermal Meta) fq. 13 (Ferdi Limani) fq. 16 (Matjan Hashani) fq. 24 (Visar Kryeziu) / Kuvendi i Kosovës: pg. 9, 10/ UNDP: fq. 15 / NDI: fq. 18